# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 13/169
Datë: 27.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2023, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Mbrojtjes së Mjedisit.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
**Qeveria – Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Planiranje i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

# KONCEPT DOKUMENT PËR FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT

**Përgatitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

**Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave**

## PËRMBAJTJA

**Shkurtesat**.....3
**Përmbledhje e koncept dokumentit**.....4
**Hyrje**.....6

**Kapitulli 1. Përkufizimi i problemit**.....9
1.1. Korniza institucionale dhe ligjore.....9
1.2. Përshkrimi dhe përcaktimi i çështjes/problemit kryesor.....25
1.3. Efektet.....28
1.4. Shkaqet.....29
1.5. Palët e interesuara bazuar në përcaktimin e problemit.....30
1.6. Gjithashtu përshkruani nëse koncept dokumenti lidhet me zbatimin e acquis të BE-së.....31

**Kapitulli 2. Qëllimi dhe objektivat**.....39
2.1. Qëllimi.....39
2.2. Objektivat.....39

**Kapitulli 3. Opsionet**.....41
3.1. Opsioni pa ndryshime.....41
3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit.....42
3.3. Opsioni i tretë është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative.....42
3.4. Përmbledhje e Opsioneve.....43

**Kapitulli 4. Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme**.....45
4.1. Përfitimet dhe ndikimet negative të opsionit të propozuar.....49
4.2 . Sfidat e mbledhjes së tëdhënave.....49

**Kapitulli 5. Komunikimi dhe konsultimi**.....50

**Kapitulli 6. Krahasimi i opsioneve**.....51
6.1. Opsioni 1 - Asnjë ndryshim.....51
6.2. Opsioni 2 - Opsioni për plotësim-ndryshim të ligjit ekzistues.....51
6.3. Opsioni 3 – Hartimi i Ligjit të ri.....51
6.4. Konsideratat e zbatimit.....51
6.5. Tabela krahasuese e tre opsioneve.....53

**Kapitulli 7. Përfundimet dhe hapat e ardhshëm**.....56
7.1. Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin.....56
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik.....57
Shtojca 2: Formulari i vlerësimit të ndikimeve sociale.....60
Shtojca 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit në mjedis.....64
Shtojca 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit të të drejtave themelore.....67

## SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| AMMK | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës |
| ZKM | Zyra e Kryeministrit |
| MINT | Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësis dhe Tregtisë |
| MFT | Ministria e Financave dhe Transfereve |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MBPZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asociimit |
| BE | Bashkimi Evropian |
| PKZMSA | Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA |
| PKZH | Plani Kombëtar për Zhvillim |

## PËRMBLEDHJE E KONCEPT DOKUMENTIT

Koncept Dokumenti për Fushën e Mbrojtjes së Mjedisit përmbanë informacione të përgjithshme për mjedisin të cilat janë të paraqitura në tabelën e më poshtme (Tabela 1).

*Tabela 1. Informacion i përgjithshëm*

| **Informacion i përgjithshëm** | |
|---|---|
| **Titulli** | Koncept Dokument për fushën e Mbrojtjes së Mjedisit |
| **Ministria udhëheqëse** | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI; Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave; |
| **Personi kontaktues** | Visare Istrefi<br>Numri i telefonit: +383 38 200 33 203 |
| **PKZH** | Plani Kombëtar Zhvillimor i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2023-2025 |
| **Prioritet strategjik** | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025:<br>2.12. Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor;<br>Strategjia dhe Plani Zhvillimor Kombëtar 2030;<br>Plani Kombëtar për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Ekonomik 2023-2025;<br>Mjedisi i pastër dhe Shtylla: I. Zhvillimi dhe shfrytëzimi më i mirë i burimeve natyrore;<br>3.7 Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe mbrojtja e biodiversitetit. |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| **Çështja kryesore** | Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (në tekstin e mëtejmë Ligji) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26.02.2009 dhe është shpallur me Dekret Presidencial më 19.03.2009. Pothuajse pesëmbëdhjetë (15) vjet pas miratimit të këtij ligji, ende nuk janë miratuar disa akte nënligjore dhe mbeten probleme të rëndësishme lidhur me zbatimin e tij. Përveç kësaj, Ligji është një ligj kornizë i cili duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE-së dhe ato kombëtare, të cilat janë miratuar në vitet e fundit. |
| **Përmbledhje e konsultimeve** | Kjo pjesë do të plotësohet gjatë konsultimeve ndërministrore për koncept dokumentin |
| | Periudha e konsultimit publik në Platformën e Konsultimeve Publike \`Online\` të MMPHI ishte nga data 28.07.2023 – 18.08.2023 |
| **Opsioni i propozuar** | Opsioni i propozuar 3.3 është: Hartimi i Projektligjit të ri për Mjedisin |

| **Ndikimet kryesor e të pritshme** | |
|---|---|
| **Ndikimet buxhetore** | Hartimi i Ligjit për Mjedisin do të ketë ndikim buxhetor dhe do të zbatohet brenda kufijve buxhetor aktual të MMPHI. |
| **Ndikimet ekonomike** | Nuk ka ndikime të pritshme përkatëse në këtë kategori. Megjithatë, përmirësimi i zbatimit të parimit \`ndotësi paguan\` do të kontribuojë në zhvendosjen e kostove për dëmtimin e mjedisit nga taksapaguesit tek operatorët dhe ndotësi i mundshëm nëpërmjet miratimit të një mekanizmi financiar *ad hoc* dhe përvetësimit të kostove mjedisore. |

| | |
|---|---|
| **Ndikimet sociale** | Hartimi i Ligjit për Mjedisin do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit; |
| **Ndikimet mjedisore** | Hartimi i Ligjit për Mjedisin do të ketë ndikim në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit; |
| **Ndikimet ndër-sektoriale** | Me hartimin e Ligjit për Mjedisin do të ketë edhe ndikime ndërsektoriale, sepse ligji parashikon bashkëpunim më të madh, me qëllim të zbatimit të tij në nivel kombëtar për mjedisin. |
| **Ngarkesat administrative për kompanitë** | Do te përfshihen gjate hartimit te Ligjit per Mjedisin. |
| **Testi i NVM (Ndërmarrjet e vogla të mesme)** | |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| **Afatshkurtra** | Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti nga Qeveria e Republikës së Kosovës, do të krijohet një grup i ri punues nga MMPHI, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara, për të filluar punën për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti duke hartuar Ligjin e ri për mjedisin. do të organizohen takime, debate publike dhe punëtori për promovimin e ligjit të ri për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të informimit të institucioneve në nivel qendror dhe lokal për mënyrën e zbatimit të tij. |
| **Afatmesme** | Me miratimin e ligjit të ri për mjedisin, do të fillohet me hartimin, plotësimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore që dalin nga ky ligj. Hartimi i akteve të reja nënligjore duke përfshirë aktivitete të caktuara në kuadër të ligjit për mbrojtjen e mjedisit do të bëhet dhe transpozohet më së voni deri në fund të vitit 2024. |

## HYRJE

Në vitin 2012, studimi i fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, konfirmoi se nuk ekzistonte asnjë pengesë ligjore për të përfunduar MSA dhe se Kosova në parim ishte e gatshme të fillonte negociatat për MSA-në – pasi që Kosova ka bërë përparim në disa prioritete.

Qëllimi kryesor i këtij Koncept Dokumenti është të identifikojë mënyrën më të qëndrueshme që:

- të harmonizojë ligjin aktual me ligjet e tjera si: Ligjin përkatës për Kundërvajtjet, Ligjin përkatës për Pyjet, Ligjin përkatës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Parandalimin e Integruar dhe Kontrolli i Ndotjes, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sidomos neni 86.3, neni 12, nenet 98 dhe 135 dhe neni 73.3;
- të përfundojë transpozimin e direktivave përkatëse të BE-së;
- të përmirësojë nivelin e zbatimit të standardeve mjedisore të BE-së dhe rrjedhimisht të kushteve mjedisore dhe shëndetësore, duke balancuar detyrimet e Kosovës që rrjedhin nga MSA-ja me kapacitetin e autoriteteve kompetente për të përmbushur kërkesat e legjislacionit të BE-së.

Ky koncept dokument synon identifikimin e problemeve dhe sfidave që lidhen me zbatimin e legjislacionit ekzistues mjedisor, duke pasur parasysh përkushtimin e Kosovës për të përafruar legjislacionin e saj me *acquis* mjedisore të BE-së (Marrëveshja e Stabilizim Asociimit – MSA – ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës). Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (në tekstin e mëtejmë Ligji) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26.02.2009 dhe i shpallur me Dekret të Presidentit më 19.03.2009, ka shfuqizuar Ligjin për mbrojtjen e mjedisit (Rregullorja 2003 /9) dhe Udhëzimin Administrativ (nr. 2/2004) për themelimin e Inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit.

Procesi i hartimit të Koncept Dokumentit për përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit mjedisor të Kosovës me *acquis të BE*-së, është iniciuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe është në përputhje me Planin Vjetor të Punës të Qeverisë për vitin 2023, në veçanti: Objektivi Strategjik 3, Aktiviteti 3.1.1.

Për të pasur një pasqyrë të qartë të ndikimit të ndryshimeve të propozuara në të gjithë kuadrin ligjor, është bere një analizë e saktë e dokumentacionit ekzistues përmes një procesi të gjerë konsultimi me të gjithë akterët përkatës të përfshirë në proces.

Për zhvillimin e këtij Koncept dokumenti janë shqyrtuar dhe analizuar burimet e mëposhtme të informacionit:

- Komentet e ofruara nga stafi kompetent në MMPHI;
- Analiza e kornizës aktuale ligjore dhe e ndikimit të ndryshimeve të propozuara në sistemin ekzistues;
- Kontributi i grupit punues, i cili përfshin anëtarë nga institucionet përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Koncept Dokumenti për fushën e Mbrojtjes së Mjedsit përmban opsione për zgjidhjen e problemeve që synojnë mbrojtjen e mjedisit, shëndetin e njeriut, ndikimin ekonomik dhe social.

*Tabela 2. Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin në fushën e mbrojtjes* së mjedisit

| **Titulli** | **Koncept dokument për fushën e mjedisit** |
|---|---|
| **Ministria udhëheqëse** | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI ;<br>Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave; |
| **Personi kontaktues** | Visare Istrefi<br>Numri i telefonit : *+383 38 200 33 203*<br>visare.hoxha@rks-gov.net |
| **PSO –Plani Strategjik Operacional 2022-2025** | • Plani Kombëtar për Zhvillim 2023-2025;<br>• Shtylla: I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;<br>• 3.1.1.Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e mjedisit |
| **Prioritet strategjik** | • Strategjia dhe Plani Kombëtar i Zhvillimit 2030;<br>• Plani Kombëtar i Zhvillimit 2023-2025;<br>• Shtylla: I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;<br>• Mjedis i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore; |
| **Grupi Punues** | 1. Visare Istrefi- DMMU /MMPHI<br>2. Ismail Hetemaj- DMMU /MMPHI<br>3. Vlora Osaj –DL/MMPHI<br>4. Lendita Sopa- DMMU MMPHI<br>5. Shiqeri Dermaku- DMMU /DMMPHI<br>6. Miradije Asllanaj- DIEKP/MMPHI<br>7. Fatlije Buza-ARPL/MMPHI<br>8. Zymer Mrasori- DKP/MMPHI<br>9. Shpresa Sheremeti- DBGJ/MMPHI<br>10. Ismet Dervari- Inspektorati/MMPHI<br>11. Albulena Maloku- DF/MMPHI<br>12. Lulzim Korenica- DE/ME<br>13. Zana Radoniqi- MF<br>14. Mirlinda Lushtaku- ZKM<br>15. Diellza Mujaj-ZKM<br>16. Fetije Muriqi- MBPZHR<br>17. Burbuqe Nushi Latifi-IKSHP/Ministria e Shendetesisë |
| **Informacion shtesë** | Zhvillimi i këtij Koncept Dokumenti është rezultat i një vlerësimi të zbatimit të ligjit aktual për Mjedisin. |

# KAPITULLI 1. PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

## 1.1. Korniza institucionale dhe ligjore

Gati (15) pesëmbëdhjetë vjet pas miratimit të Ligjit ende nuk janë miratuar disa akte nënligjore dhe mbeten ende probleme të theksuara lidhur me zbatimin e tij. Përveç kësaj Ligji është një ligj kornizë, i cili duhet të harmonizohet me ligjet e BE-së dhe ato kombëtare, të cilat janë miratuar vitet e fundit.

### 1.1.1. Përshkrimi i politikës ekzistuese dhe kornizës ligjore

Ligji përcakton kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe parimet themelore të menaxhimit të mjedisit, synon të arrijë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke përafruar gradualisht legjislacionin kombëtar mjedisor me standardet BE-së, përmes transpozimit të legjislacionit të mëposhtëm të BE-së:

1. Direktiva nr. 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28.01.2003 "Për qasjen e publikut në informacionin mjedisor" dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit nr. 90/313/EEC[1];
2. Direktiva nr. 2004/35/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21.04.2004 "*Për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor*" e ndryshuar me Direktivën 2006/21/EC, 2009/31. /KE dhe 2013/30/EU[2];
3. Direktiva nr. 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19.11.2008 "*Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal.*"[3];
4. Direktiva nr. 2003/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26.05.2003 "*për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara në lidhje me mjedisin*" dhe ndryshimin e Direktivave të Këshillit nr. 85. /337/EEC dhe 96/61/KE "*për pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi*"[4].

Ligji ofron bazën ligjore për zhvillimin e akteve nënligjore zbatuese përkatëse. Në Tabelën më poshtë janë renditur bazat ligjore e nxjerrjes së akteve nënligjore dhe aktet e miratuara:

---

[1] Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28 janar 2003 mbi qasjen e publikut në informacionin mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/EEC, *OJ L 41, 14.2.2003, p. 26–32* - *https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32003L0004*

[2] Direktiva nr. 2004/35/CE "Për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor" e ndryshuar nga Direktiva 2006/21/EC, 2009/31/EC, Direktiva 2013/30/BE dhe Rregullorja (BE) 2019/1010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të dates 5 qershor 2019, *OJ L 143, 30.4.2004, p. 56–75* - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0035

[3] Direktiva 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal (Tekst me rëndësi për ZEE-në (Zona Ekskluzive Ekonomike)), *OJ L 328, 6.12.2008, p. 28–37* - *https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32008L0099*

[4] Direktiva 2003/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 maj 2003, që parashikon pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara në lidhje me mjedisin dhe që ndryshon në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi; Direktivat e Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC - Deklaratë nga Komisioni, *OJ L 156, 25.6.2003, p. 17–25* - *https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32003L0035*

*Tabela 3. Ligji: Udhëzimet Administrative dhe statusi aktual*

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucion i shtetëror përgjegjës për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit** |
|---|---|---|---|
| Udhëzim Administrativ Nr. 04/2022 për Lejen mjedisore, duke shfuqizuar Udhëzimin Administrativ Nr. 7/2017 | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 31,par.3 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=59421 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Lëshimin e lejes mjedisore komunale, duke shfuqizuar Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2015 | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 32,par.1 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14799 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2021 për Autorizimin mjedisor, duke shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2015, të ndryshuar me Udhëzimi Administrativ nr. 3/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 për autorizimin mjedisor | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 33,par.1 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=59211 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2018 për Parandalimin e aksidenteve të mëdha me substanca të rrezikshme, duke shfuqizuar Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2011 për Parandalimin e aksidenteve të mëdha me substanca të rrezikshme | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 35, par.5 dhe neni 47,par 2. të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17832 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 për Metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 35, par.5 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7984 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ i QRK-së nr. 11/2018 për Vlerat e kufizuara të shkarkimeve të materialeve të ndotura në tokë | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 36, të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18815 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për alarmet publike | Nuk ështe miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Statusin e mjedisit të rrezikuar | Nuk ështe miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrat |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | iv në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Etiketimin mjedisor | Nuk ështe miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Prodhimin dhe vendosjen në treg të substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 45,paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10309 | | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Monitorimin e mjedisit | Nuk ështe miratuar | | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Monitorimin | Nuk ështe miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti |

| | | | |
|---|---|---|---|
| e emetimeve, cilësinë mjedisore dhe mbledhjen e të dhënave | | | kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2016 për Sistemin informativ mjedisor | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 52,paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13178 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2013 - për Kadastrën e shkarkimeve të ndotësve të mjedisit | Akti nënligjor në fjalë është i nxjerrur duke u bazuar në nenin 53,paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10111 | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Ofrimin e informacionit mjedisor sipas kërkesës | Nukështe miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Detyrat e organizatave të tjera të autorizuara | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ mbi Përgjegjësinë për dëmin | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Kompensimin për shfrytëzimin e burimeve natyrore | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kompensimin e ndotjes së mjedisit | | | kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Kompensimin e përcaktuar nga komuna | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |
| Udhëzimi Administrativ për Stimujt ekonomikë | Nuk është miratuar | MMPHI | MMPHI është autoriteti kompetent për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit |

Raporti i progresit i BE-së për vitin 2022[5] përsëriti disa rekomandime për të përafruar legjislacionin e tij me qëllimet e Agjendës së Marrëveshjes së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor[6]:

[5] DOKUMENTI I PUNËS SË STAFIT TË KOMISIONIT Kosovë * 2022 Raporti shoqërues i dokumentit *Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve* 2022 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të BE-së https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf

[6] DOKUMENTI I PUNËS SË STAFIT TË KOMISIONIT Udhëzimet për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor e shoqërojnë Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve; Një Plan Ekonomik dhe Investiv për Ballkanin Perëndimor https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf

*"Kosova është në një fazë **të hershme të përgatitjes** për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Kosova ka bërë **progres të kufizuar**, veçanërisht në raportimin mjedisor dhe monitorimin e cilësisë së ajrit. Kosova duhet të rrisë angazhimin e saj politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike, si dhe të përmirësojë ndjeshëm zbatimin e legjislacionit të saj, për ta harmonizuar atë me Agjendën e Gjelbër për qëllimet e Ballkanit Perëndimor. Shumica e rekomandimeve nga raporti i mëparshëm janë ende në pritje. Në vitin e ardhshëm Kosova në veçanti duhet:*

- *të rrisë kapacitetin e mbulimit dhe grumbullimit të mbeturinave, të zbatojë reduktimin e gjerë te mbeturinave, të bëjë riciklimin e ndarjes dhe ripërdorimin e mbetjeve, të trajtojë në mënyrë efektive çështjen e deponive të paligjshme dhe të prezantojë masat e ekonomisë qarkore, të reduktoj mbeturinat, të zhvillojë dhe miratojë plane të menaxhimit të integruar ndërkomunal të mbeturinave dhe të krijojë sistemin e zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesve;*
- *të harmonizoj dhe të filloj zbatimin e dispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin; të implementoj parimin **`ndotësi paguan`** dhe **`ndërgjegjësimi i publikut`** për mbrojtjen e mjedisit;*
- *të zbatojë strategjinë e **ndryshimeve klimatike** dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike, të përgatisë një udhërrëfyes për përafrimin me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe acquis për klimën dhe të miratojë një Plan Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë dhe të finalizojë hartimin strategjisë afatgjate të dekarbonizimit."*

Më konkretisht sa i përket statusit të legjislacionit horizontal, raporti thekson se Kosova ka nevojë që:

- Të miratojë strategji të rishikuara, plane veprimi dhe legjislacione për të siguruar koherencën e tyre me objektivat e Agjendës së Gjelbër dhe për të siguruar zbatimin e tyre.
- Të harmonizojë mbrojtjen e tij mjedisore me direktivën e përgjegjësisë mjedisore.
- Të miratojë legjislacionin e inspektimeve mjedisore për të përmirësuar kapacitetin zbatues.
- Të ndryshojë dhe zbatojë ligjet për vlerësimin e ndikimit strategjik në mjedis.
- Të rrisë koordinimin ndërinstitucional dhe përfshirjen e shoqërisë civile.
- Të marrë përsipër përgjegjësitë e ndërgjegjësimit nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç u përmend më lart, Ligji dhe legjislacioni sekondar përkatës, transpozojnë një pjesë të konsiderueshme të *acquis* horizontale mjedisore të BE-së.
Megjithatë, që nga miratimi i tij janë bërë disa ndryshime në BE dhe në kornizën ligjore kombëtare, të cilat duhet të pasqyrohen në Ligji.

<u>Ndryshime të rëndësishme në kontekstin e BE-së:</u>

- Direktiva nr. 2004/35/CE "*për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor*": Direktiva u ndryshua disa herë, ndryshimet zgjeruan fushën e përgjegjësisë strikte duke shtuar "menaxhimin e mbeturinave nga industritë nxjerrëse" dhe "operimin në vendet e magazinimit në përputhje me Direktivën 2009/31/EC" në listën e aktiviteteve të rrezikshme profesionale në Aneksin III të ELD. Direktiva për sigurinë në det, që përmban një ndryshim në ELD (zgjerimi i fushës së dëmtimit të ujërave detare), u miratua në qershor 2013 dhe nuk është i zbatueshëm në Kosovë. Rregullorja e Përshtatjes së Raportimit, përshtati kërkesat e raportimit me nevojën për të krijuar një bazë më të mirë të provave (lloji i dëmtimit mjedisor, data e shfaqjes dhe/ose zbulimi i dëmit)). <u>Këto ndryshime nuk janë përfshirë në ligj.</u>

- Direktiva nr. 2003/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26.05.2003 "*për pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara në lidhje me mjedisin*" dhe ndryshimin e Direktivave të Këshillit Nr. 85/ 337/KEE dhe 96/61/KE "*për pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi*". Direktiva u ndryshua në vitin 2016 me Direktivën 2016/2284 për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, Neni 19 për "Amendamentin e Direktivës 2003/35/KE" shtoi pikën e mëposhtme: (g) Neni 6(1) i Direktiva (BE) 2016/2284 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 dhjetor 2016 për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, që ndryshon Direktivën 2003/35/EC dhe shfuqizon Direktivën 2001/81/EC. Ky ndryshim u transpozua nëpërmjet ligjit nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (shih Tabela 2 më poshtë).

Ndryshime të rëndësishme në kontekstin kombëtar:

- Duhet theksuar se procesi i harmonizimit të ligjeve kombëtare mjedisore me direktivat e BE-së është intensifikuar në dy vitet e fundit dhe disa ligje të reja në fushën e legjislacionit horizontal u miratuan (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Raportimi, INSPIRE), cilësia e ajrit, kontrolli i ndotjes industriale, siç përshkruhet në tabelen e mëposhtme:

***Tabela 4. Ligjet e fundit të kornizës mjedisore***

| Legjislacioni mjedisor në Kosovë | ***Referencat për acquis të BE-së*** |
|---|---|
| **Ligji Nr. 08/L-137 për Pyjet[7]** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën e Këshillit 1999/105/EC për tregtimin e materialit riprodhues pyjor; Rregullorja e (BE) Nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që përcakton detyrimet e operatorëve që vendosin lëndë druri dhe produkte druri në treg (e njohur si Rregullorja ilegale e Lëndëve të Drurit); Rregullorja (BE) Nr. 691/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian për Llogaritë Ekonomike Mjedisore; Rregullorja (BE) Nr. 363/2012 mbi rregullat procedurale për njohjen dhe tërheqjen e njohjes së organizatave monitoruese siç parashikohet në Rregulloren (BE) Nr. 995/2010, Rregullorja (BE) Nr. sistemi i kujdesit të duhur, shpeshtësia dhe natyra e kontrolleve në organizatat monitoruese siç parashikohet në Rregulloren (BE) Nr. 995/2010. |
| **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis [8]:** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/52/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 prill 2014, e cila ndryshon Direktivën 2011/92/BE për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private. |
| **Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja [9]:** | Ky ligj është në përputhje me Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor, Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, |

[7] Ligji nr. 08/l-137 Për pyjet; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / no. 9 / 3 Prill 2023, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=71815

[8] Ligji nr. 08/l-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 / 6 janar 2023, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708

[9] Ligji nr. 08/l-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 18 / 13 korrik 2022, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60330

| | |
|---|---|
| | kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit dhe Direktivën 2006/2284/EC për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, duke ndryshuar Direktivën 2003/35/EC dhe duke shfuqizuar Direktivën 2001/81/EC. |
| **Ligji Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes[10]:** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2010/75/BE, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes). |
| **Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikatet[11]** | Ky ligj është duke e ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 04/L-197 për Kimikatet, dhe pjesërisht është në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1907/2006 të Parlamentit Evropian; dhe të Këshillit të 18 dhjetorit 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e një Agjencie Evropiane të Kimikateve, që ndryshon Direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 1488/94, si dhe Direktiven e Këshillit 76/769/EEC dhe Direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/KE, duke përfshirë të gjitha ndryshimet dhe korrigjimet në REACH të miratuara deri më tani. |
| **Ligji Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat [12]** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit i 19 Nëntorit 2008 për Mbeturinat. |
| **Ligji Nr. 08/L-027 për Mbeturinat nga Industritë Nxjerrëse [13]** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/21/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 mars 2006 për menaxhimin e mbeturinave nga industritë nxjerrëse dhe që ndryshon Direktivën 2004/35/EC, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L. 102, 11.4.2006. |
| **Ligji Nr. 08/L-010 për Themelimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës [14]** | Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën e Bashkimit Evropian 2007/02 BE të Parlamentit Evropian të datës 14.03.2007, e cila përcakton Infrastrukturën e Informacionit Hapësinor në Komunitetin Evropian (Direktiva INSPIRE) |

Në vitin 2022 është miratuar edhe Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet, qëllimi i ligjit është të përcaktojë parimet e inspektimit, themelimin e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, rregullat për organizimin e organeve inspektuese në kompetencë të shtetit dhe komunës, administrimin si dhe

[10] Ligji nr. 08/l-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 8/ 29 Mars 2023, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71734

[11] Ligji nr. 08/l-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-197 për kimikatet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 30 / 5 Shtator 2022, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62592

[12] Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për mbeturinat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 29 / 1 Shtator 2022, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62435

[13] Ligji nr. 08/l-027 për mbeturinat nga industritë nxjerrëse, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 16 / 4 Korrik 2022, Prishtinë 25- https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60163

[14] Ligji nr. 08/l-010 për themelimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr 16 / 4 KORRIK 2022, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60162

përcaktimin e rregullave për koordinimin dhe procedurën e inspektimit. Ky ligj zbatohet për të gjitha funksionet gjithë-inspektuese, përveç atyre të renditura në nenin 2, përfshirë inspektimet mjedisore.

*Tabela 5. Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit | G.Z. nr. 50/2009 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631&langid=2 | MMPHI | Përcakton kornizën e përgjithshme ligjore dhe parimet themelore të menaxhimit të mjedisit, synon të arrijë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke përafruar gradualisht legjislacionin kombëtar mjedisor me standardet e BE-së |
| Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit | GZ RKS no. 43/2013 dt.29.10.2013 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8910 | MMPHI | Rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, koordinimin e mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedurat për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje të tjera të |

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| | | | rëndësishme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese. |
| Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës | GZ RKS no. 85, dt. 09.11.2010 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716 | MMPHI | Rregullon sistemin e mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të saj. |
| Ligji Nr. 08/L-137 për Pyjet | GZ e RKS no. 9, dt. 03.04.2023 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71815 | MBPZHR | Rregullon planifikimin, mbrojtjen, silvikulturën, përdorimin e produkteve nga druri dhe produkteve jodrunore, pronësinë, shpronësimin, përgjegjësinë organizative dhe detyrat e institucioneve pyjore, financimin publik, kërkimin pyjor, mbikëqyrjen, inspektimin dhe sanksionet. |
| Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë | GZ e RKS no. 8, dt. 01.01.2007 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2433 | MBPZHR | Menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si pasuri natyrore me interes |

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| | | | të përgjithshëm, që gëzojnë mbrojtje të veçantë. |
| Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor | GZ e RKS no. 30, dt. 23.08.2013 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865 | MMPHI | Siguron zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Republikës së Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të duhur të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. |
| Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor | GZ e RKS no. 83, dt. 29.10.2010 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2711 | MMPH | Rregullon vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, duke siguruar kështu një shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. |

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 08/ L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis | GZ e RKS no. 2, dt. 6. Janar 2023 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708 | MMPHI | Synon parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë kontribuon në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. |
| Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore | GZ e RKS no. 16, dt. 26.06.2015 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923 | ABGJ | Garantimi, mbrojtja dhe promovimi i barazisë gjinore |
| Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 86.3 (parimi i vetem nje here, neni 12 rreth pageses se procedures, nenet 98 dhe 135 sa i perket ofrimit te sherbimit me kohe (afatet) dhe nenit 73.3 mundesia per komunikime elektronike ne vend te komunikimit fizik. | GZ e RKS no.20/2016, dt. 21.06.2016 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559 | MAP | Zbatimi i procedurave të përgjithshme administrative. Siguron zbatimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ligjore të personave. |

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 | GZ e RKS no. 2, dt. 14.01.2019 https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413 | MPJ, Inspektorati i Mjedisit MMPH, Inspektorati Komunal, Policia, Gjykatat | Ndër të tjera, rregullon sanksionet për vepra penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore. |
| Ligji Nr. 05/L087 për Kundërvajtje | OG RKS no. 33/2016 dt. 08.09.2016 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839 | MPJ | Gjobat dhe denimet për shkelje të dispozitave ligjore. |
| Ligji Nr. 03/L-154 për pronën dhe të drejtat e tjera sendore | GZ e RKS nr. 57, dt. 04.08.2009 https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2643 | MPJ | E drejta pronësore |
| Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 | GZ e RKS Nr. 13/2007 dt. 01.06.2007 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2450 | MBPZHR | Rregullimi i tokave bujqësore |
| Ligji 04/ L-040 për Rregullimin e Tokës (Amendamentim/Plotësim)<br>Ligji Nr. 08/L-112 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/-26 për Tokën Bujqësore (AK) | GZ e RKS / Nr. 28 / 2022, dt, 30.08. 2022 https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=62340 | MBPZHR | Rregullimi i tokave bujqësore |

| **Dokumentet e politikave, ligji ose akti nënligjor** | **Linku *(website)* i internetit për politikën ose dokumentin e planifikimit ose akteve ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni shtetëror përgjegjës për zbatimin** | **Roli dhe detyrat e institucionit** |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale | GZ e RKS Nr. 28 dt. 04.06.2008 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530 | MAPL | Ky ligj përcakton statusin juridik të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet ndërkomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror. |

**Lejet mjedisore**

Ligji dhe aktet nënligjore përkatëse identifikojnë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si autoritet përgjegjës në nivel qendror për dhënien e lejeve mjedisore dhe autorizimeve mjedisore (Neni 31 dhe 33 të Ligjit), ndërsa komunat janë përgjegjëse për lëshimin e lejeve mjedisore komunale (Neni 32 të Ligjit).

Pas miratimit të akteve nënligjore të parapara në Ligj, MMPHI dhe komunat kanë filluar zbatimin e dispozitave të ligjit. Në tabelen 6 janë përshkruar disa informacione në lidhje me aplikimin për Leje Mjedisore, lejet e lëshuara dhe aktualisht në shqyrtim.

***Tabela 6. Statusi i aplikimit për leje mjedisore***

| **VITI** | **2018 - 2023** |
|---|---|
| **Numri i aplikimeve për leje të dorëzuara në nivel kombëtar** | 698 |
| **Numri i lejeve të lëshuara në nivel kombëtar** | 452 |
| **Numri i aplikimeve për leje në proces në nivel lokal** | 81 |
| **Numri i kërkesave për leje të refuzuara në nivel kombëtar** | 331 |

### 1.1.2. Përshkrimi i kornizës institucionale ekzistuese

Sa i përket strukturës institucionale, administrata përgjegjëse për politikën e mjedisit dhe klimës është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ku Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), monitoron gjendjen e mjedisit me mbështetjen e Inspektoratit Qendror dhe Komunal të Mjedisit.

Megjithatë, për të përmbushur detyrimet e saj sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore dhe administrative në përputhje me standardet mjedisore dhe klimatike të BE-së.

Institucionet për të zbatuar standardet e BE-së janë të vendosura, por kapaciteti i tyre për të zbatuar legjislacionin në nivel qendror dhe lokal duhet të forcohet.

Sipas Rregullores (QRK) Nr.5/2017, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës të MMPH, Departament pergjegjes për mbikëqyrjen administrative të zbatimit të Ligjit për Mjedisin është Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (DMMU). Departamenti është përgjegjës për zbatimin e funksioneve të mëposhtme: (i) propozon, zhvillon dhe siguron zbatimin e dokumenteve/strategjive të politikave në fushën e mbrojtjes së mjedisit; (ii) propozon, zhvillon dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së mjedisit; (iii) monitoron

dhe propozon masat për rehabilitimin dhe mbajtjen nën kontroll të pikave të nxehta; (iv) identifikon dhe propozon nevojat për investime dhe financim në fushën e mbrojtjes së mjedisit; (v) siguron mbështetje për çështjet që lidhen me anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit; (vi) siguron mbështetje, sipas rastit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e burimeve natyrore dhe pjesëve përbërëse të tyre; (vii) merret me dokumentacionin e kërkesave për leje mjedisore, jep rekomandime për rregullsinë dhe në përputhje me rrethanat përgatit draft-lejet mjedisore.

Buxheti i alokuar nga Ministria e Financave për sektorin në nivel qendror dhe lokal nuk është i mjaftueshëm (afërsisht 4 milionë euro/vit), dhe shqetësimet mjedisore dhe klimatike nuk janë përfshirë në politikat e tjera. Kosovës i mungojnë kapacitetet e mjaftueshme njerëzore, administrative dhe financiare për të zbatuar standardet mjedisore dhe klimatike të BE-së.

### 1.1.3.Shpenzimet aktuale

*Tabela 7. Shpenzimet aktuale*

| Kategoria e shpenzimeve | Shpenzimet aktuale të vitit të kaluar | Buxheti i këtij viti | KASH për vitin e ardhshëm |
|---|---|---|---|
| **Buxheti i Ministrisë (Rendisni çdo lloj shpenzimi)**<br>**P&M – Pagat dhe mëditjet**<br>**M&Sh – mallra dhe shërbime**<br>**IK – Investimet Kapitale** | 36,158,396.68 | 49,121,434 | 48,557,601 |
| **Buxhete të tjera (Rendisni çdo lloj shpenzimi)** | | | |
| **Financim nga donatorët** | 1,294,548.53 | | |
| **Ministria e Financave Shpenzimet direkte** | | | |

### 1.2. Përshkrimi dhe sqarimi i çështjes/problemit kryesor

Pothuajse pesëmbëdhjetë (15) vjet pas miratimit të Ligjit në fuqi, ende nuk janë miratuar disa akte nënligjore dhe mbeten disa probleme lidhur me zbatimin e tij.
Përveç kësaj Ligji është një ligj kornizë, i cili duhet të përafrohet me disa ligje të rëndësishme të BE-së dhe me ligjet kombëtare, të cilat janë miratuar viteve të fundit (Tabelën 3), dhe të harmonizohet me strukturën ekzistuese institucionale.

Pas analizës së problemit të përshkruar më sipër, Tabela më poshtë paraqet boshllëqet dhe mospërputhjet kryesore të referuara në Ligji.

*Tabela 8. Mangësitë dhe mospërputhjet e Ligjit për Mjedisin*

| Kapitulli i Ligjit | Mangësitë dhe mospërputhjet |
|---|---|
| **Kreu I - Dispozitat e përgjithshme** | • Përkufizimet duhet të integrohen dhe të përputhen me legjislacionin sektorial të miratuar rishtazi (ju lutemi referojuni Tabeles 2) dhe me politikën ekzistuese të BE-së.<br>• Organizimi institucional duhet gjithashtu të përafrohet me kornizen ekzistuese institucionale dhe administrative në nivel qendror dhe vendor dhe me legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencisë së pavarur. |
| **Kapitulli II - Shfrytëzimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore** | • Terminologjia dhe referenca ndaj strukturës institucionale duhet të përafrohet me kornizen ligjore dhe institucionale ekzistuese në nivel BE dhe kombëtar. Mungon veçanërisht referenca për ekonominë qarkore. |
| **Kapitulli III - Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit** | • Terminologjia dhe referenca ndaj strukturës institucionale duhet të përafrohet me kornizen ligjore dhe institucionale ekzistuese, në nivel të BE dhe kombëtar. Mungon veçanërisht referenca për ekonominë qarkore. |
| **Kapitulli IV - Masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit** | • Ky Kapitull duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, legjislacionin e mbeturinave, kimikatet, etj. (Ju lutemi referojuni Tabeles 2), dhe të harmonizohet me strukturën ekzistuese institucionale. |
| **Kapitulli V - Monitorimi dhe informacioni për mjedisin** | • Ky Kapitull duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, legjislacionin e mbeturinave, kimikatet, etj. (Ju lutemi referojuni Tabeles 2), dhe të harmonizohet me strukturën ekzistuese institucionale. |
| **Kapitulli VI - Informimi dhe pjesëmarrja e publikut** | • Ky Kapitull duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (veçanërisht me Nenin 16 për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen në procedurën e VNM) dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes (në veçanti me Kapitulli 4 dhe Shtojca 4 për pjesëmarrjen e publikut dhe qasja në informacion), legjislacioni për mbeturinat, kimikatet, etj. (Ju lutemi referojuni Tabeles 2) dhe të harmonizohet me strukturën ekzistuese institucionale. |
| **Kapitulli VII - Organizatat për monitorimin e mjedisit** | • Ky Kapitull duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, legjislacionin e mbeturinave, kimikateve, etj. (Ju lutemi referojuni Tabeles 2).<br>• Organizimi institucional duhet gjithashtu të përafrohet me kornizen ekzistuese institucionale dhe administrative, në nivel qendror dhe vendor dhe me legjislacionin që rregullon |

| | |
|---|---|
| | organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencisë së pavarur. |
| **Kapitulli VIII - Detyrimet dhe përgjegjësitë për ndotjen e mjedisit** | Për të zbatuar parimin Ndotësi paguan (ju lutemi referojuni rekomandimeve të Raportit të Progresit të BE-së 2022), ky Kapitull duhet të jetë:<br>• Në përputhje me legjislacionin e BE-së për përgjegjësinë mjedisore, të ndryshuar (ju lutemi referojuni paragrafit mbi Ndryshimet e rëndësishme në kontekstin e BE-së) dhe me kornizen ekzistuese institucionale dhe administrative në nivel qendror dhe lokal.<br>• I harmonizuar me legjislacionin sektorial të sapomiratuar.<br>• Duhet të zgjidhen disa mospërputhje me legjislacionin e BE-së dhe duhet të përfundojë transpozimi i Direktivës për Përgjegjësinë Mjedisore, p.sh.:<br>o Tiparet kryesor e të direktivës duhet të përafrohen me direktivën: përcaktimi i dëmit mjedisor dhe sanimi i tij, i cili duhet të përputhet më mirë me legjislacionin e BE-së dhe me legjislacionin kombëtar të ujit, biodiversitetit dhe tokës.<br>o Përkufizimi i regjimeve të përgjegjësisë (të rreptë dhe të bazuara në faj);<br>o Neni 71 i referohet rimbursimit të dëmit duke deklaruar se çdo person i prekur nga dëmi ka të drejtën e rimbursimit. Direktiva nuk parashikon kompensim për publikun. Qëllimi i tij është të parandalojë shfaqjen e dëmit mjedisor dhe nëse ndodh të sigurojë që ai të korrigjohet. Nëse dëmtimi mjedisor shkakton dëm për publikun ose prek mallrat dhe pronën e tyre, duhet të zbatohen ligjet kombëtare të përgjegjësisë civile. |
| **Kapitulli IX - Financimi për mbrojtjen e mjedisit** | • Ky Kapitull duhet të harmonizohet me kornizen ligjore, institucionale dhe administrative ekzistuese, në nivel qendror dhe vendor.<br>• Mekanizmi për rimbushjen e Fondit Mjedisor mund të lidhet me mekanizmat e përgjegjësisë mjedisore që do të vendosen (Kapitulli VIII). |
| **Kapitulli X - Mbikëqyrja** | Ky Kapitull duhet të harmonizohet me kornizen ligjore, institucionale dhe administrative ekzistuese në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht me ligjin nr. 08/L-067 për inspektimet. |

Qëllimi i këtij rishikimi është të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe rrjedhimisht të shëndetit të njeriut, duke harmonizuar kornizen ligjore mjedisore, përmes përafrimit të Ligjit për Mjedisin në kontekstin aktual ligjor të BE-së dhe atë kombëtar.

Për të kuptuar më mirë problemin ekzistues në fushën e trajtuar nga ky koncept dokument, është zhvilluar dhe shtjelluar pema e mëposhtme e problemeve.

*Figura 5: Pema e problemit, duke treguar problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij*




### 1.2.1. Problemi kryesor

Ky nën-kapitull përshkruan shkaqet dhe pasojat e problemeve, të cilat trajtohen në këtë Koncept Dokument.

Siç u përmend më lart, problemet kryesore të identifikuara janë se terminologjia dhe struktura institucionale e përshkruar në ligj nuk është në përputhje me kornizat ekzistuese në nivel kombëtar dhe të BE-së.
Përveç kësaj, një pjesë e acquis mjedisore horizontale të BE-së që rregullon parimin `ndotësi paguan` nuk është transpozuar dhe zbatuar plotësisht / saktë.

Këto mospërputhje krijojnë probleme në zbatimin e ligjit dhe, për rrjedhojë krijojn edhe një mbrojtje të pamjaftueshme të mjedisit, me ndikime negative në burimet natyrore dhe shëndetin e njerëzve.

Ligji për Mjedisin duhet te jete ne harmoni me Ligjin per proceduren e pergjithshme administrative dhe Programin e Qeverise per Parandalimin dhe Zvogelimin e Barres Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2025.

Ligji për Mjedisin është një ligj kornizë, i cili duhet të harmonizohet me strukturën ekzistuese institucionale dhe ligjore.

### 1.3. Efektet

Problemet e përmendura më sipër kanë gjeneruar disa efekte negative, të cilat kanë ndikuar negativisht në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

*a) Transpozimi jo i plotë dhe zbatimi i dispozitave të Ligjit për Mjedisin*

Në përgjithësi, transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është relativisht i avancuar, veçanërisht pas miratimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit Nr. 08/l-181 dhe Ligjit nr. 08/l-010 për themelimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, edhe pse nevojiten përpjekje shtesë për të përfunduar transpozimin e legjislacionit për përgjegjësinë mjedisore dhe për të siguruar zbatimin e drejtë të parimit `ndotësi paguan`.

Ligji për Mjedisin është një ligj kornizë, i cili duhet të harmonizohet me strukturën ekzistuese ligjore dhe institucionale. Mungesa e harmonizimit krijon probleme në zbatimin e tij dhe zbatimin e dispozitave të ligjit, zbatim të dobët të parimit `ndotësi paguan` dhe nivel më të ulët të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. Kapitulli 1.2 përshkruan në detaje mangësitë dhe konfliktet me kornizen ekzistuese ligjore dhe institucionale.

***b) Zbatimi i dobët i parimit `ndotësi paguan`***

Për të zbatuar parimin `Ndotësi paguan`, siç parashikohet në Raportin e Progresit të BE-së 2022, Ligji duhet të përafrohet me Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore. Aktualisht transpozimi është i paplotë dhe seksionet e transpozuara nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së.
Krijimi i një sistemi të përgjegjësisë mjedisore, në përputhje me Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore, po siguron zbatimin e parimit `ndotësi paguan`, që do të thotë se kostot e rehabilitimit mjedisor duhet të përballohen nga subjekti që i ka prodhuar këto kosto nëpërmjet aktiviteteve të tyre ndotëse, dhe jo nga publiku në përgjithësi. Mungesa e një sigurie financiare për të mbuluar detyrimin mjedisor, rrit rrezikun që kostot të përballohen nga taksapaguesit në rast falimentimi të ndotësit.

***c) Qytetarët dhe shoqëria civile, të pa informuar për burimet mjedisore dhe statusin e tyre***

Përfshirja e publikut është thelbësore për të siguruar një mbrojtje efektive të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

Rregulloret e paqarta në lidhje me të drejtat dhe detyrat e publikut dhe shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes mjedisore, po pengojnë efektivitetin e legjislacionit.

Prandaj, ligji duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (veçanërisht me nenin 16 për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen në procedurën e VNM) dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes (veçanërisht me Kapitullin 4 dhe Shtojcen 4 për pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në informacion), legjislacionin e mbeturinave, si dhe kimikatet, të harmonizuara me strukturën ekzistuese institucionale.

### 1.4. Shkaqet

Shkaqet e problemeve janë:

a) Boshllëqet ligjore.
b) Mungesa e kapaciteteve.

**a) Boshllëqet (mangësitë) ligjore**

Ligji Nr. 03/L-025 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" përcakton kornizën e përgjithshme ligjore dhe parimet themelore të menaxhimit të mjedisit në vend, synon arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke përafruar gradualisht legjislacionin kombëtar mjedisor me standardet e BE-së përmes transpozimit të disa legjislacioneve të BE-së.

Duhet theksuar se procesi i harmonizimit të ligjeve kombëtare mjedisore me direktivat e BE-së është intensifikuar në 2 vitet e fundit dhe janë miratuar disa ligje të reja në fushën e legjislacionit horizontal (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor, raportimi, INSPIRE), cilësia e ajrit, kontrolli i ndotjes industriale, siç përshkruhet në tabelen 4.

Ligjit i mungon harmonizimi me Direktivën nr. 2004/35/CE "*mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor*": Direktiva u ndryshua disa herë, ndryshimet zgjeruan fushën e përgjegjësisë strikte duke shtuar "menaxhimin e mbeturinave nga industria nxjerrëse" dhe "operimi i vendeve të depozitimit në përputhje me Direktivën 2009/31/EC" në listën e aktiviteteve të rrezikshme profesionale në Aneksin III të Direktivës, për Përgjegjësinë Mjedisore. Direktiva për sigurinë në det, që përmban një ndryshim në Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore (zgjerimi i fushës së dëmtimit të ujërave detare), është miratuar në qershor 2013 dhe nuk është e aplikueshme në Kosovë. Rregullorja e Përshtatjes së Raportimit përshtati kërkesat e raportimit me nevojën për të krijuar një bazë më të mirë të provave (lloji i dëmtimit mjedisor, data e shfaqjes dhe/ose zbulimi i dëmit). Këto ndryshime nuk janë përfshirë në ligj.

Prandaj, ligji duhet të harmonizohet me acquis horizontale mjedisore të BE-së, si dhe legjislacionin sektorial të miratuar rishtazi për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, legjislacionin e mbeturinave, kimikatet, etj.

**b) Mungesa e kapaciteteve**

Implementimi dhe zbatimi i legjislacionit mjedisor sfidohet nga mungesa e fondeve dhe kapaciteteve administrative.

Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore kërkon caktimin e një ose më shumë "autoriteteve kompetente" për të zbatuar dispozitat e saj. Kapaciteti i autoriteteve kompetente për të ndërmarrë veprime sipas Direktivës, do të pengohet nëse ka një mekanizëm zbatues joefektiv dhe të paqartë dhe nga mungesa e fondeve për restaurimin e dëmit mjedisor.

Kosova ende duhet të harmonizojë mbrojtjen e saj mjedisore me direktivën e përgjegjësisë mjedisore, dhe të zhvillojë/përmirësojë kapacitetet e autoriteteve kompetente, në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e dëmit mjedisor ndaj ujit, biodiversitetit dhe tokës.

## 1.5. Palët e interesit bazuar në përkufizimin e problemit

Tabela 9 më poshtë i liston palët e identifikuara të interest. Ajo gjithashtu tregon nëse ato ndikohen nga shkaqet, efektet ose të dyja. Për më tepër, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ndikohen ato.

***Tabela 9 - Pasqyrë e palëve të interesit bazuar në përkufizimin e problemit***

| **Emri i palës së interesit** | **Shkaqet me të cilat është e lidhur pala** | **Efekti me të cilin është e lidhur pala** | **Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) ose pasojë (pasoja)** |
|---|---|---|---|
| **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës** | 1. Ligji nuk është në përputhje me Direktivën nr. 2004/35/CE *"për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe kompenzimin e dëmit mjedisor"*<br>2. Mungesa e përafrimit të ligjit me strukturën ekzistuese ligjore dhe institucionale. Mungesa e përkufizimit të qartë të përgjegjësive institucionale.<br>3. Mungesa e kapaciteteve dhe mungesa e informacionit publik. | 1. Mungesa e transpozimit të një pjese të acquis mjedisore horizontale të BE-së dhe zbatimi i dispozitave të ligjit.<br><br>2. Zbatimi i pamjaftueshëm i ligjit ka rezultuar në rrezik për burimet natyrore dhe shëndetin e njerëzve | Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar, monitorimi dhe zbatimi. |
| **Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës** | Mungesa e stafit dhe kapacitetet e pamjaftueshme. | Mungesa e të dhënave, të nevojshme për zhvillimin e politikave mjedisore. | Agjencia ndikohet drejtpërdrejt përmes monitorimit dhe raportimit. |
| **Bizneset** | Zhvillimi ekonomik dhe social. | Degradimi dhe ndotja e mjedisit | Mungesa e një organizimi të qartë |

| Emri i palës së interesit | Shkaqet me të cilat është e lidhur pala | Efekti me të cilin është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) ose pasojë (pasoja) |
|---|---|---|---|
| | | | institucional dhe sistemi i lejeve po pengon investimet dhe zhvillimin e bizneseve. |
| **Qytetarët** | Zhvillimi ekonomik dhe social. | Degradimi dhe ndotja e mjedisit | Qytetatrët i bartin pasojat e mungesës së mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. |
| **Operatoret** | Ofrimi i shërbimeve | Pelqime, leje dhe licenca | Ofrimi isherbimeve bazuar ne legjisacion primar dhe sekondar per Pelqime, leje dhe licenca |

### 1.6. Përshkruani gjithashtu nëse Koncept Dokumenti është i lidhur me zbatimin e *acquis* të BE-së

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti lidhet veçanërisht me zbatimin e *Acquis të BE-së* në fushën e mjedisit. Pra, duke marrë parasysh përkushtimin e Republikës së Kosovës për ta harmonizuar legjislacionin e sektorit të mjedisit me atë të BE-së dhe për ta zbatuar atë në mënyrë efektive, përkatësisht nenin 115 – Mjedisi, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit – MSA, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016.

Raporti i progresit i BE-së për vitin 2022[15] përsëriti disa rekomandime të dhëna në Raportin për vitin 2021, për ta përafruar legjislacionin e tij me qëllimet e Agjendës së Marrëveshjes së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor[16], duke theksuar rëndësinë e *harmonizimit dhe fillimit të zbatimit të ispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin; zbatimin e* ***parimit ndotësi paguan*** *dhe* ***ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut*** *për mbrojtjen e mjedisit;*

[15] DOKUMENTI I PUNËS SË STAFIT TË KOMISIONIT Kosovë* Raporti i vitit 2022 *shoqërues i dokumentit* Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve 2022 Komunikatë mbi politikën e zgjerimit të BE-së https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf

[16] DOKUMENTI I PUNËS SË PERSONELIT TË KOMISIONIT Udhëzues për zbatimin e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor që e shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Një Plan Ekonomik dhe Investues për Ballkanin Perëndimor https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/green_agenda_for_the_western_balkans_en.pdf

Më konkretisht sa i përket statusit të legjislacionit horizontal, raporti thekson se Kosova ka nevojë për:

- T'i miratojë strategjitë e rishikuara, planet e veprimit dhe legjislacionin për ta siguruar koherencën e tyre me objektivat e Axhendës së Gjelbër dhe për të siguruar zbatimin e tyre.
- Ta harmonizojë mbrojtjen e tij mjedisore me direktivën e përgjegjësisë mjedisore.
- Ta miratojë legjislacionin e inspektimeve mjedisore për ta përmirësuar kapacitetin zbatues.
- T'i ndryshojë dhe t'i zbatojë ligjet për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe strategjik.
- Ta rrisë koordinimin ndërinstitucional dhe përfshirjen e shoqërisë civile
- Të marrë përsipër përgjegjësitë e ndërgjegjësimit nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç u përmend më lart, Ligji ekzistues dhe legjislacioni sekondar përkatës, po transpozojnë një pjesë të konsiderueshme të acquis horizontale mjedisore të BE-së, në veçanti:

1. Direktiva nr. 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28.01.2003 "*për qasjen e publikut në informacionin mjedisor*" dhe që e shfuqizon Direktivën e Këshillit Nr. 90/313/EEC[17];
2. Direktiva nr. 2004/35/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21.04.2004 *"për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe kompenzimin e dëmit mjedisor"* e ndryshuar nga Direktiva 2006/21/EC, 2009/31/EC dhe 2013/30/E[18];
3. Direktiva nr. 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19.11.2008 *"për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drjetës penale"*[19];
4. Direktiva nr. 2003/35/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 26.05.2003 *"për pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara në lidhje me mjedisin" dhe që ndryshon Direktivat e Këshillit nr. 85/337/KEE dhe 96/61/KE "për pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi"*[20].

[17] Direktiva 2003/4/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 28 janarit 2003 mbi qasjen e publikut në informacionin mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/KEE, OJ L 41, 14.2.2003, f. 26–32 - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32003L0004

[18] Direktiva Nr. 2004/35/CE *"për përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe kompenzimin e dëmit mjedisor"* e ndryshuar nga Direktiva 2006/21/EC, 2009/31/EC, Direktiva 2013/30/EU dhe Rregullorja (EU) 2019/1010, L.J, 2019/1010 e Këshillit të Parlamentit Evropian19,33 e 20105 dhe 4.2004, f. 56–75 - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0035

[19] Direktiva 2008/99/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale (Tekst me rëndësi për EEA), OJ L 328, 6.12.2008, f. 28–37 - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32008L0099

[20] Direktiva 2003/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 maj 2003 që parashikon pjesëmarrjen e publikut lidhur me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara në lidhje me mjedisin dhe që ndryshon në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi Direktivat e Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC - Deklarata e Komisionit, OJ L 156, 25.6.2003, f. 17–25 - https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32003L0035

***Tabela 10 - Transpozimi i Direktivave të BE-së në legjislacionin mjedisor***

| Nr. | Emri i direktivës | Viti i miratimit | Qëllimi | Harmonizimi në legjislacionin kombëtar (%) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Direktiva Nr. 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28.01.2003 *"për qasjen e publikut në informacionin mjedisor"* dhe që e shfuqizon Direktivën e Këshillit Nr. 90/313/EEC. | Aplikohet që nga 14 shkurti 2003. Vendet e BE-së duhej ta përfshinin atë në legjislacionin kombëtar deri më 14 shkurt 2005. | Ajo përshtat plotësisht ligjet kombëtare të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) me Konventën e Aarhus-it të vitit 1998 për qasje në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore.<br>Ajo garanton qasjen e publikut në informacionin mjedisor të mbajtur nga, ose për, autoritetet publike, si me **kërkesë** ashtu edhe nëpërmjet **shpërndarjes aktive**.<br>Ajo përcakton kushtet bazë, kushtet dhe rregullimet praktike që një anëtar i publikut duhet të respektojë kur i jepet akses në informacionin e kërkuar mjedisor. | 100% |
| 2 | Direktiva nr. 2003/35/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26.05.2003 *"për pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin"* dhe ndryshimin e Direktivave të | Zbatohej që nga 26 maji 2003 dhe duhej të bëhej ligj deri më 25 qershor 2005 | Objektivi i kësaj direktive është të kontribuojë në zbatimin e detyrimeve që dalin nga Konventa e Århus-it, në veçanti nga:<br>(a) sigurimi i pjesëmarrjes së publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara lidhur me mjedisin;<br>(b) përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut dhe sigurimin e dispozitave për aksesin | 100% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Këshillit Nr. 85/337/KEE dhe 96/61/KE *"për pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi"*. | | në drejtësi | |
| 3 | Direktiva Nr. 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19.11.2008 *"për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale"*. | Aplikohet që nga 26 dhjetori 2008 dhe duhej të bëhej ligj në Shtetet Anëtare deri më 26 dhjetor 2010. | Përcakton një numër shkeljesh të rënda që e dëmtojnë mjedisin.<br>Kërkon që shtetet anëtare të BE-së të vendosin dënime efektive dhe proporcionale që përbëjnë një pengesë për vepra të tilla, pavarësisht nëse ato janë kryer me dashje ose nga pakujdesia serioze. | 50% |
| 4 | Direktiva 2004/35/EC për përgjegjësinë mjedisore, lidhur me parandalimin dhe përmirësimin e dëmtimit mjedisor (Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore). | Direktiva u miratua në prill 2004. Ajo trajton vetëm dëmet dhe ngjarjet e dëmshme që ndodhin pas afatit të fundit për transpozim në nivel shteti anëtar, 30 prill 2007. | Direktiva për Përgjegjësinë Mjedisore synon t'i bëjë të gjithë autorët përgjegjës ligjërisht dhe financiarisht për dëmtimet në mjedis (ujë, tokë dhe natyrë). | 76% |

Ligji aktual në përgjithësi ka transpozuar direktivat kryesore të BE-së në fushën e legjislacionit horizontal mjedisor. Kornizës ligjore i mungon harmonizimi me 2004/35/KE për përgjegjësinë mjedisore, në lidhje me parandalimin dhe përmirësimin e dëmtimit mjedisor.
Dispozitat e mbetura do të transpozohen gradualisht, në përputhje me progresin e Kosovës drejt anëtarësimit në BE.

### 1.6.1. Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Në dhjetor 2019, Komisioni Evropian miratoi Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane (MGjE). Agjenda e Gjelbër Evropiane paraqet një seri veprimesh që përcaktojnë politikën e BE-së për vitet e ardhshme në fusha të tilla si klima, energjia, ekonomia qarkore, biodiversiteti, politika industriale, tregtia, etj. Objektivi kryesor i marrëveshjes është tranzicioni i qëndrueshëm i gjelbër i Evropës në kontinentin neutral ndaj klimës deri në vitin 2050.

Agjenda e Gjelbër Evropiane është ende në zhvillim e sipër, pasi është një mjet dinamik. Strategjitë, planet, kornizat ligjore për zbatimin e AGjE janë hartuar dhe disa janë ende në përgatitje.

Këtu janë renditur disa nga objektivat e përcaktuara nga marrëveshja e gjelbër për biodiversitetin, ujin dhe tokën:

- Shtetet Anëtare të sigurojnë që të mos ndodh asnjë përkeqësim i tendencave të ruajtjes dhe statusit të të gjitha habitateve dhe specieve të mbrojtura deri në vitin 2030.
- Përveç kësaj, Shtetet Anëtare do të duhet të sigurojnë që të paktën 30% e specieve dhe habitateve që aktualisht nuk janë në status të favorshëm, ose janë në atë kategori, të tregojnë një tendencë të fortë pozitive.
- Programi i 8-të i Veprimit Mjedisor synon të ndjekë një ambicie për ndotje zero, duke përfshirë mbrojtjen, ruajtjen dhe rivendosjen e biodiversitetit dhe rritjen e kapitalit natyror, veçanërisht ajrin, ujin dhe tokën, si dhe pyjet, ujërat e ëmbla, ligatinat dhe ekosistemet detare.

Objektivat dhe veprimet në strategjitë e BE-së zbatohen përmes direktivave dhe politikave specifike mjedisore si Direktiva Kornizë e Ujërave, Direktiva e Përmbytjeve, Direktiva e Habitateve dhe Direktiva e Zogjve të Egër.

Këto direktiva që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe ekosistemeve mjedisore (p.sh.: Cilësia e ajrit, uji, biodiversiteti), përdorin të gjitha standardet e cilësisë si mjet për të formuluar qëllimet e Direktivave dhe të mbështeten në njohuritë shkencore. Këto direktiva përdorin plane dhe programe për të drejtuar zbatimin në nivel kombëtar.

Legjislacioni horizontal/mundësues është si një mjet ndërsektorial, për të siguruar arritjen e objektivave të politikës mjedisore të BE-së, ai plotëson instrumentet e tjera të Bashkimit, që synojnë mbrojtjen e mjedisit. Prandaj, zbatimi i saktë dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor dhe institucional ekzistues është veçanërisht i rëndësishëm për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së burimeve mjedisore dhe të shëndetit të njeriut.

Neni 191(2) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian thotë: "Politika e Unionit për mjedisin synon një nivel të lartë mbrojtjeje, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e situatave në rajone të ndryshme të Bashkimit. *Ai do të bazohet në parimin e parandalimit dhe në parimet që duhet të ndërmerren veprime parandaluese, që dëmtimi mjedisor të korrigjohet si prioritet në burim, dhe se ndotësi duhet të paguajë".*

Për shembull, krijimi i një sistemi të përgjegjësisë mjedisore, në përputhje me Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore, po siguron zbatimin e parimit ndotësi paguan, që do të thotë se kostot e rehabilitimit mjedisor duhet të përballohen nga subjekti që i ka prodhuar këto kosto, nëpërmjet ndotësve të tyre, aktiviteteve, dhe jo nga publiku në përgjithësi. Mungesa e një sigurie financiare për të mbuluar detyrimin mjedisor rrit rrezikun që kostot të përballohen nga taksapaguesit, në rast falimentimi të ndotësit.

### 1.6.2. Përvoja në vende të tjera

Për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti për të identifikuar opsionin më të përshtatshëm, janë analizuar edhe ligjet mjedisore të Republikës së Kroacisë dhe Republikes se Maqedonisë Veriore.

*Republika e Kroacisë*

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2013 (i ndryshuar) përcakton parimet e mbrojtjes së mjedisit në kuadër të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së komponentëve mjedisorë dhe mbrojtjes nga presionet mjedisore. Ai përcakton institucionet dhe autoritetet kompetente për mbrojtjen e mjedisit, përcakton kërkesat dhe proceset administrative për zhvillimin efektiv të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, instrumentet për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin e mjedisit, sistemin e informacionit, sigurimin e qasjes në informacionin mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut në çështjet mjedisore, aksesin në drejtësi, përgjegjësinë për dëmtimin, financimië dhe instrumentet e politikës së përgjithshme mjedisore, mbikëqyrjen administrative dhe inspektuese dhe shumë çështje të tjera të lidhura me to.

Ky Ligj është në përputhje me disa legjislacione të BE-së, konkretisht: Direktiva 2011/92/BE për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis, Direktiva 2003/35/KE që parashikon pjesëmarrjen e publikut në lidhje me hartimin e planeve dhe programeve të caktuara, Direktiva 2001/42/KE për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, Direktiva 2010/75/BE për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes); Direktiva 2003/105/EC 2003 që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/82/EC e datës 9 dhjetor 1996 mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme, Direktiva 2003/4/EC për aksesin publik në informacionin mjedisor, Direktiva 2004/35/EC mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor; Direktiva 2008/56/KE që krijon një kornizë për veprimin e komunitetit në fushën e politikave mjedisore detare (Direktiva ëornizë e Strategjisë Detare); Direktiva 2001/116/EC që i përshtatet progresit teknik të Direktivës së Këshillit 70/156/KEE për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtareë lidhur me miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, Direktiva 1999/94/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 dhjetorit 1999 lidhur me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO2, në lidhje me tregtimin e makinave të reja për pasagjerët;

Përveç kësaj, ky ligj rregullon kornizën për zbatimin e akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian: Rregullorja (KE) Nr. 66/2010 për Etiketën Ekologjike të BE-së; Rregullorja (EC) Nr. 1221/2009 mbi pjesëmarrjen vullnetare të organizatave në një skemë komunitare për menaxhimin dhe auditimin ekologjik (EMAS), Rregullorja (EC) Nr. 166/2006 në lidhje me krijimin e një Regjistri Evropian të çlirimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR); dhe Rregullorja (EC) Nr. 401/2009 për Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe Rrjetin Evropian të Informacionit dhe Vëzhgimit të Mjedisit (versioni i kodifikuar).

Ligji eshtë i ndarë në XV Kapitulj dhe 279 Nene, duke përfshirë kundërvajtjet dhe dënimet përkatëse, dhe shfuqizon Aktin për Mbrojtjen e Mjedisit të miratuar në vitin 2007, i cili nga ana e tij shfuqizoi Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, i hyrë në fuqi më 19 nëntor 1994.

*Republika e Maqedonisë së Veriut*

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisi përcakton informacionin mjedisor dhe përcakton procesin e qasjes në të; ai përmban dispozita për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe kërkon që autoritetet shtetërore të informojnë publikun për rastet e ndotjes së mjedisit. Ligji ka dispozita për informacionin e etiketimit të produktit dhe eko-etiketimin. Ai përcakton parimet për pjesëmarrjen e publikut në Vendimin dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e dokumenteve ligjore dhe të politikave dhe në Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), me të drejtën e ankimimit të Vendimit në lidhje me aktivitetin e bazuar në projekt. Ligji kërkon disponueshmërinë e informacionit mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), organizimin e dëgjimeve publike, aksesin në informacion mbi aplikimet për Leje të Integruara Mjedisore (LIM), marrjen e komenteve nga publiku dhe apelimet kundër një vendimi.

Që nga viti 2011, Ligji për Mjedisin i vitit 2005 është ndryshuar më shumë se 10 herë. Ndryshimet më të rëndësishme iu referuan: procedurës së vlerësimit strategjik mjedisor (VSM) (2011, 2013); lëshimi i lejeve të integruara mjedisore (LIM) (2011); parandalimi dhe kontrolli i aksidenteve në prani të substancave të rrezikshme (2012); sistemi kombëtar për inventarin e emetimeve të gazrave serrë (GHG) (2013); licencimi për trajtimin e ftohësve (2014); dhe organizimi i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit (ISHM) (2015), për të qenë në përputhje me reformën e sistemit të inspektimit (Inspektorati Shtetëror) dhe ndryshime të tjera përkatëse në kornizen ligjore/institucionale në nivel kombëtar dhe të BE.

### 1.6.3. Analiza e krahasimeve ndërmjet shteteve

Të dyja vendet e analizuara, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut kanë një ligj kornizë mjedisore, duke vendosur parime dhe duke ofruar strukturën e përgjithshme të kornizave ligjore dhe institucionale mjedisore. Përveç kësaj, në të dyja rastet Ligji për Mjedisin transpozon një pjesë të konsiderueshme të *acquis* horizontale mjedisore të BE-së.
Vështrimi i shkurtër i dhënë më sipër tregon se në të dyja rastet ligjet për mjedisin janë ndryshuar disa here, në mënyrë që të jenë në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor në nivel kombëtar dhe të BE-së.

# KAPITULLI 2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

## 2.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është të rishikojë politikën ekzistuese kombëtare mjedisore, të identifikojë opsionin më të mirë të mundshëm për të rritur nivelin e zbatimit të parimeve themelore të BE-së, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe për rrjedhojë përmirësimin e kushteve mjedisore dhe shëndetësore.

Ky Koncept Dokument është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në politikën mjedisore dhe klimatike të përcaktuara nga Qeveria.

## 2.2. Objektivat

Objektivi strategjik
Objektivi strategjik i kësaj politike është përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit.

Objektivat specifike:
- Rishikimi i politikave ekzistuese kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.
- Harmonizimi i legjislacionit dhe politikave të tjera përkatëse.

Digjitalizimi I procedurave administrative ne dhenien e sherbimeve (leje, pelqime),ne perputhje me Ligjin per proceduren e pergjithshme administrative dhe Programin e Qeverise per Parandalimin dhe Zvogelimin e Barres Administrative 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2022-2025.

***Tabela 11. Objektivat relevante të Qeverisë***

| Objektivi relevant | Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi) |
|---|---|
| Bashkëpunimi do të synojë të promovojë modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë dhe sektorëve individualë në Kosovë. Gjithashtu do të synojë të sigurojë që kushtet e nevojshme për konkurrencën e industrisë së Kosovës ekzistojnë në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit. | MSA [21] - Neni 99 Bashkëpunimi industrial |
| Bashkëpunimi mund të përqendrohet gjithashtu në [..] ekzekutimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor. | MSA - Neni 115 Mjedisi |
| 3.27. Acquis Kapitulli 27: Mjedisi | Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (PKMSA), 2022-2026[22] |
| Të plotësohet me referencë të saktë | Programi Legjislativ për vitin 2023, i miratuar në mbledhjen 121 të Qeverisë së Republikës së Kosovës |

[21] Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës*, nga ana tjetër https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf
[22] https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/3-PKZMSA-2022-2026_ang.pdf

| | |
|---|---|
| | me Vendimin nr. 02/121, datë 25.01.2023. |
| Ndërtimi i kapaciteteve dhe ngritja e ndërgjegjësimit social dhe institucional për mbrojtjen e mjedisit | Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025) - Objektivi specifik III.[23] |
| Sa i përket statusit të legjislacionit horizontal, Kosova ka nevojë:<br>• Të miratojë strategji të rishikuara, plane veprimi dhe legjislacion, për të siguruar koherencën e tyre me objektivat e Agjendës së Gjelbër dhe për të siguruar zbatimin e tyre.<br>• Të harmonizojë mbrojtjen e tij mjedisore me direktivën e përgjegjësisë mjedisore.<br>• Të miratojë legjislacionin e inspektimeve mjedisore për të përmirësuar kapacitetin zbatues.<br>• Të ndryshojë dhe zbatojë ligjet për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe strategjik.<br>• Të rrisë koordinimin ndërinstitucional dhe përfshirjen e shoqërisë civile.<br>• Të marrë përsipër përgjegjësitë e ndërgjegjësimit nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile. | Raporti i Progresit të BE-së 2022 |
| Masat e Reformës #9: Reduktimi i ndotjes së mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit | Programi Kombëtar i Reformës Ekonomike (PRE) 2023-2025[24] |

[23] Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025) - https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2022/01/ENG-ACTION-PLAN-2021-2023.pdf
[24] https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1619B453-0328-4C3D-889F-CF262574AA11.pdf

# KAPITULLI 3. OPSIONET

Grupi Punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti ka shqyrtuar tre opsione, me synimin për të arritur objektivat e përcaktuara në Kapitullin 3. Opsioni i parë është opsioni status quo, ose opsioni pa ndryshim. Opsioni i dytë është përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore, që nënkupton zbatimin e kornizes ligjore ekzistuese, dokumenteve planifikuese, rregulloreve dhe akteve nënligjore, të cilat do të krijonin kushte për një menaxhim të suksesshëm të mbrojtjes së natyrës. Opsioni i tretë është hartimi i ligjit të ri për mjedisin.

Për të ofruar përfitime të konsiderueshme për cilësinë e jetës dhe për të dhënë kontribut në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, janë analizuar opsionet e mëposhtme:

1. Opsioni i parë: Nuk kërkohen ndryshime ligjore (Status quo).
2. Opsioni i dytë: Të përmirësohet zbatimi i ligjit për mjedisin përmes miratimit/ndryshimeve/përmirësimit të legjislacionit sekondar që mungon, i cili duhet sa më shumë të jetë e mundur, që të përshtatet me ligjin e sektorit mjedisor të miratuar së fundi (Ndrysho qasjen ekzistuese në zbatim).
3. Opsioni i tretë: Të ndryshohet Ligji (Ndrysho politikën ekzistuese).

## 3.1. Opsioni pa ndryshime

Në përgjithësi, transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është relativisht i avancuar, veçanërisht pas miratimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit Nr. 08/l-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis [25] dhe Ligjit nr. 08/l-010 për themelimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës [26], megjithatë nevojiten veprime shtesë për të harmonizuar kornizen ligjore kombëtare me acquis të BE-së. Edhe pse disa dispozita, veçanërisht lidhur me përgjegjësinë mjedisore, nuk janë transpozuar ende.

Detyrat dhe përgjegjësitë e MMPHI-së dhe institucioneve përkatëse janë të përcaktuara në ligj. Procedurat për qasje në informacion dhe për pjesëmarrjen e publikut janë rregulluar me ligj dhe aktet nënligjore përkatëse.

Korniza ligjore mbetet e pandryshuar.

Miratimi i Opsionit 1 do të rezultonte në mospërputhje me acquis të BE-së dhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Përveç kësaj, mospërputhjet me legjislacionin e miratuar rishtazi mund të gjenerojnë zbatime dhe kufizime në zbatim, për shkak të bashkëekzistencës së dispozitave të mundshme konfliktuale.

## 3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

[25] Ligji nr. 08/l-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 2 / 6 janar 2023, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68708

[26] Ligji nr. 08/l-010 për themelimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr 16 / 4 KORRIK 2022, Prishtinë - https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60162

Përmirësimi i zbatimit të ligjit për mjedisin përmes miratimit/ndryshimeve të legjislacionit sekondar që mungon, i cili duhet sa më shumë të jetë i përshtatur me ligjin për sektorin e mjedisit, të miratuar së fundmi (Ndryshimi i qasjes ekzistuese në zbatim).
Duke pasur parasysh se parimet themelore të legjislacionit mjedisor janë të rregulluara në Ligj, mund të bëhen disa përmirësime përmes miratimit dhe ndryshimeve të legjislacionit sekondar përkatës.

Siç u përshkrua më lart në Tabelen 1, disa udhëzime administrative (UA) ende nuk janë miratuar, përveç kësaj, UA në fuqi mund të ndryshohen më lehtë se Ligji.
Nuk nevojiten ndryshime ligjore (përveç miratimit të legjislacionit zbatues që mungon) dhe struktura institucionale mbetet e pandryshuar.

Mund të nevojiten procedura të brendshme për të përmirësuar efikasitetin në zbatimin e legjislacionit ekzistues.
Mangësitë në transpozimin e Direktivës së Përgjegjësisë Mjedisore do të mbeten, si dhe mospërputhjet ligjore dhe institucionale me kornizen ligjore të ndryshuar.

**3.3. Opsioni i tretë është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative**

Opsioni i tretë i shqyrtuar është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri, i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore të hasura dhe do të rregullonte sfidat e reja të krijuara si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit. Kjo në të njëjtën kohë do të ju jepte zgjidhje problemeve me të cilat janë ballafaquar të gjithë akteret e involvuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Për të ndryshuar Ligjin, nevojiten ndryshime të rëndësishme në kornizën aktuale ligjore. Në veçanti janë prekur Ligji dhe legjislacioni tjetër përkatës primar dhe sekondar.

Pas vlerësimit të kryer, nevojiten ndryshimet kryesor e të mëposhtme:

- Organizimi institucional duhet gjithashtu të përafrohet me kornizen ekzistuese institucionale dhe administrative në nivel qendror dhe vendor dhe me legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencisë së pavarur, dhe me Ligjin per Proceduren e Pergjithshme Administrative dhe Programin e Qeverise per Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative.
- Ligji duhet të harmonizohet me legjislacionin sektorial të sapomiratuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (pjesëmarrja në procedurën e VNM) dhe për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollin e Ndotjes, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në informacion, legjislacionin e mbetjeve, kimikatet, etj. Ju lutemi referojuni Tabeles 2).
- Për të zbatuar parimin Ndotësi paguan (ju lutemi referojuni rekomandimeve të Raportit të Progresit të BE-së 2022), ky Kapitull duhet të:

    - Të ndryshoj kapitujt që lidhen me përgjegjësinë mjedisore për të qenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe për të transpozuar dispozitat që mungojnë. Tiparet kryesore të direktivës duhet të përafrohen me direktivën: përcaktimi i dëmit mjedisor dhe sanimi

i tij, i cili duhet të përputhet më mirë me legjislacionin e BE-së dhe me legjislacionin kombëtar të ujit, biodiversitetit dhe tokës.
- Të përkufizoj regjimin e përgjegjësisë (rreptësisht dhe të bazuar në faj);
- Neni 71 i referohet rimbursimit të dëmit duke deklaruar se çdo person i prekur nga dëmi ka të drejtën e rimbursimit. Direktiva nuk parashikon kompensim për publikun. Qëllimi i tij është të parandalojë shfaqjen e dëmit mjedisor dhe, nëse ndodh, të sigurojë që ai të korrigjohet. Nëse dëmtimi mjedisor shkakton dëm për publikun ose prek mallrat dhe pronën e tyre, duhet të zbatohen ligjet kombëtare të përgjegjësisë civile.
- Mekanizmi për rimbushjen e Fondit Mjedisor mund të lidhet me mekanizmat e përgjegjësisë mjedisore që do të vendosen (Kapitulli VIII).
- Ligji duhet të harmonizohet me Ligjin nr. 08/L-067 për inspektimet.
- Thjeshtimi dhe ku eshte e mundshme, digjitalizimi I procedures per ofrimin e sherbimeve adminsitrative per palet (leje, pelqime dhe cdo sherbim tjeter qe e leshon MMPHI bazuar ne Ligjin e mjedisit)

Duke marrë parasysh ndryshimet e nevojshme, rekomandohet hartimi i Ligjit të ri për Mjedisin. Nuk parashikohen ndryshime të rëndësishme institucionale; megjithatë, dispozitat e ligjit duhet të përafrohen me kornizën ekzistuese institucionale.

### 3.4. Përmbledhje e Opsioneve

*Tabela 12. Përmbledhje e opsioneve*

| PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE | | | |
|---|---|---|---|
| **Karakteristikat kryesore** | OPSIONI I | OPSIONI II | OPSIONI III |
| ***Karakteristikat kryesore të opsioneve*** | Nuk ka ndryshime | Të miratojë/ndryshojë legjislacionin sekondar që mungon | Për ndryshimin e ligjit |
| ***Popullsia e synuar/sektorët/rajonet e prekura*** | I gjithë vendi duke përfshirë të gjitha komunitetet | I gjithë vendi duke përfshirë të gjitha komunitetet | I gjithë vendi duke përfshirë të gjitha komunitetet |
| ***Karakteristikat e zbatimit / kush është përgjegjës – Qeveria (kush), sektorët privatë, qytetarët*** | MMPHI, komunat, operatorët, Inspektorët e Mjedisit, OJQ, OSHC, Publiku | MMPHI, komunat, operatorët, Inspektorët e Mjedisit, OJQ, OSHC, Publiku | MMPHI, komunat, operatorët, Inspektorët e Mjedisit, OJQ, OSHC, Publiku |
| ***Administrimi ose ofrimi i programit ose shërbimeve*** | MMPHI | MMPHI | MMPHI |
| ***Ligji, ndryshimi i legjislacionit sekondar, zbatimi, sanksionet*** | Nuk parashikohen ndryshime ligjore | Miratimi i legjislacionit sekondar që mungon (Potenciali) Ndryshimi i akteve nënligjore ekzistuese | Nevojiten disa ndryshime: Ligji për Mjedisin Legjislacioni sekondar përkatës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | për t'u përshtatur me kontekstin ligjor | |
| ***Stimujt ose dekurajimet ekonomike, taksat ose subvencionet*** | Asnjë | Të promovojë miratimin e mekanizmave financiarë dhe skemave vullnetare të menaxhimit mjedisor. | Prezantimi i një sistemi të qartë dhe efektiv të përgjegjësisë, mund të nxisë operatorët të investojnë në parandalimin dhe të miratojnë një mekanizëm financiar, që do të aktivizohet në rast të dëmtimit të mjedisit. |
| ***Fushatatë edukative dhe komunikimi*** | Komunikimi dhe takimet me aktorët përkatës | Përmirësimi i përfshirjes së publikut nëpërmjet legjislacionit për VNM dhe PIKN. | Komunikimi dhe takimet me aktorët përkatës |
| ***Udhëzimet dhe kodet*** | Legjislacioni ekzistues | Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues | Rishikimi i legjislacionit përkatës |
| ***Afati kur Opsioni do të bëhet efektiv*** | Aktualisht në fuqi | Koha e nevojshme për miratimin e legjislacionit sekondar që mungon. | Koha e nevojshme për ndryshimet ligjore dhe për hyrjen në fuqi të dispozitave (që do të përcaktohen në periudhën kalimtare) |

## KAPITULLI 4. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË TË ARDHMEN

Për analizën e një koncept dokumenti nuk është e mjaftueshme të deklarohet se shkaqet e problemit do të largohen dhe se problemi rrjedhimisht do të zgjidhet. Veprimet duhet të vendosen në një kontekst të gjerë që merr parasysh të gjitha efektet e mundshme që veprimet e Qeverisë mund të kenë. Kjo nënkupton analizën e pesë kategorive të ndikimeve potenciale në vijim:

1) ndikimet ekonomike;
2) ndikimet shoqërore;
3) ndikimet mjedisore;
4) ndikimet ndërsektoriale;
5) ndikimet buxhetore.

Këto ndikime janë përmbledhur në formë tabelare në tabelën më poshtë.

*Tabela 13. Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| Kategoritë e ndikimeve | Ndikimet përkatëse të identifikuara |
|---|---|
| *Ndikimet ekonomike* | Zbatimi i dobët i parimit `ndotësi paguan` dhe mungesa e një sistemi përgjegjësie, do të rrisë rrezikun që kostot për dëmtimin mjedisor të përballohen nga tatimpaguesi.<br>Miratimi i të gjitha akteve nënligjore të parashikuara në ligj, do të përmirësojë zbatimin e parimit `ndotësi paguan` dhe mund të shkaktojë detyrime shtesë për operatorët: të miratojnë masa parandaluese për të reduktuar rrezikun e një dëmi dhe të krijojnë një mekanizëm financiar për ndreqjen e tij, nëse ndodh dëmtimi. Megjithatë, nuk do të jetë e mundur të krijohet një sistem i përgjegjësisë mjedisore në përputhje me BE-në vetëm përmes akteve nënligjore. Do të nevojitet një ndryshim në ligj.<br>Përmirësimi i zbatimit të parimit `ndotësi paguan`: Me vendosjen e sistemit të përgjegjësisë, operatorët mund të detyrohen të miratojnë një mekanizëm financiar për të korrigjuar dëmin mjedisor (duke përfshirë kostot mjedisore). Ligji ekzistues rregullon pjesërisht përgjegjësinë mjedisore, por dispozitat aktuale nuk janë në përputhje me direktivën e përgjegjësisë mjedisore (llojet e aktiviteteve operacionale që i nënshtrohen regjimit(eve) të përgjegjësisë nuk janë identifikuar).<br>Për të reduktuar barrën shtesë për operatorin, dispozitat e përgjegjësisë duhet të harmonizohen sa më shumë që të jetë e mundur me legjislacionin PIKN.<br>Zbatimi i parimit `ndotësi paguan` do të shmangë/kufizojë rrezikun që kostot të përballohen nga taksapaguesit. |

| | |
|---|---|
| ***Ndikimet shoqerore*** | Përfshirja e aktorëve përkatës dhe publikut në procesin e krijimit të Vendimit, do të mbetet e kufizuar.<br>Pa një sistem përgjegjësie, qytetarët rrezikojnë të përballojnë koston e riparimit, në rast të dëmtimit të mjedisit.<br>Përfshirja e palëve të interesuara dhe publikut në procesin e krijimit të Vendimit, mund të përmirësohet përmes miratimit të legjislacionit sekondar që mungon dhe zbatimit të dispozitave ligjore ekzistuese.<br>Përafrimi i ligjit me kornizen ligjore dhe institucionale ekzistuese në nivel të BE-së dhe në nivel kombëtar, do të përmirësojë pjesëmarrjen e publikut, qasjen në informacionin mjedisor dhe qasjen në drejtësinë mjedisore.<br>Përveç kësaj, zbatimi i parimit \`ndotësi paguan\` do të shmangë/kufizojë rrezikun që kostot të përballohen nga taksapaguesit. |
| ***Ndikimet mjedisore*** | Zbatimi i dobët i parimit ndotësi paguan dhe krijimi i një sistemi përgjegjësie dhe mekanizmash financiarë, mund të ndikojë negativisht në burimet mjedisore, në veçanti ujin, biodiversitetin dhe tokën.<br>Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe miratimi i atyre që mungojnë, do të përmirësojë ndikimet në burimet mjedisore.<br>Përafrimi me acquis mjedisore të BE-së do të përmirësojë mekanizmat për parandalimin e dëmeve dhe për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. |
| ***Ndikimet në të drejtat themelore*** | Aktualisht palët e interesuara dhe pjesëtarët e publikut nuk janë mjaftueshëm të përfshirë dhe të informuar në procesin e krijimit të Vendimit.<br>Zbatimi i legjislacionit ekzistues dhe miratimi i atij që mungon do të përmirësojë aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e publikut.<br>Ndryshimi i legjislacionit ekzistues do të përmirësojë dhe qartësojë mekanizmat për përfshirjen e aktorëve përkatës dhe të publikut në procesin e krijimit të Vendimit. |
| ***Ndikimi gjinor*** | Gjinia nuk është e integruar sa duhet në ligj. |
| ***Ndikimet e barazisë sociale*** | |
| ***Ndikimet tek të rinjtë*** | |
| ***Ndikimi i NMV-ve*** | |

### 4.1. Përfitimet dhe ndikimet negative të opsionit të propozuar

***Tabela 14. Përfitimet dhe Ndikimet negative të Opsionit 3***

| Opsioni | Përfitimet | Ndikimet negative |
|---|---|---|
| Opsioni 1 – Status Quo | Miratimi i Opsionit 1 nuk do të kërkojë asnjë ndryshim ligjor, duke shmangur çdo ndikim në ngarkesën e institucioneve kompetente.<br>Nuk ka detyrime dhe shpenzime shtesë për rishikimin e kornizes ligjore ekzistuese. | Nuk ka përmirësim në nivelin e transpozimit të acquis të BE-së dhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.<br>Ruajtja e "Status quo-së" nuk do të ketë asnjë ndikim në procesin e përafrimit me acquis të BE-së.<br>Zbatimi i parimit \`ndotësi paguan\` nuk do të përmirësohet. |
| Opsioni 2 – Të përmirësohet zbatimi i ligjit përmes miratimit/ndryshimeve të legjislacionit sekondar që mungon (Ndryshimi i qasjes ekzistuese në zbatim) | • Miratimi i legjislacionit sekondar që mungon do të përmirësojë zbatimin e ligjit.<br>• Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues do të rrisë nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. | Përmirësim i kufizuar në nivelin e transpozimit të acquis të BE-së dhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. |
| Opsioni 3 - Të ndryshohet Ligji (Ndrysho politikën ekzistuese) | • Përmirësimi i harmonizimit ndërmjet legjislacionit dhe procedurave mjedisore<br>• Niveli më i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit<br>• Pajtueshmëria me MSA dhe me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes industriale.<br>• Sigurohet përafrimi me acquis të BE-së. | Nevojiten ndryshime të rëndësishme në kornizen ligjore, kjo do të kërkojë përfshirjen e stafit teknik dhe ligjor me pasojë rritjen e ngarkesës.<br>Operatorët do t'i nënshtrohen dispozitave të përgjegjësisë mjedisore, duhet të merren parasysh kostot shtesë për operatorët, veçanërisht për krijimin e mekanizmave financiarë. |

### 4.2 Sfidat e mbledhjes së të dhënave

Nuk kishte sfida të rëndësishme sa i përket mbledhjes së të dhënave

## KAPITULLI 5. KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Gjatë hartimit dhe pas miratimit të Koncept Dokumentit do të organizohen takime të ndryshme me institucione vendore dhe ndërkombëtare, draftet do të publikohen për komente nga publiku, ndërsa pas miratimit do të nisë fushata promovuese si dhe informimi i publikut.

***Tabela 15. Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument***

Procesi i konsultimit ka për qëllim:
- Të njoftojë institucionet e nivelit qendror dhe vendor, si dhe publikun, për procesin e hartimit të Koncept Dokumentit për fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- Të përmbush detyrimet në drejtim të harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së.
- Të identifikoj palët që do të kenë detyrime për monitorimin dhe raportimin e të dhënave.
- Transparencë gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për fushën e mbrojtjes së mjedisit.

| **Qëllimi kryesor** | **Grupi i synuar** | **Aktiviteti** | **Komunikimi/njoftimi** | **Afati indikativ** | **Buxheti i nevojshëm** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Takimi është i hapur për të gjithë të interesuarit | Të gjithë të interesuarit | Takimi publik | Komunikimi përmes faqes së internetit dhe e-mail | Shtator 2023 | | MMPHI, MF, MBPZHR |
| Konsultimi publik me shkrim | Institucionet publike (qendrore dhe lokale) | Publikimi i konsultimit në portalin e konsultimit publik | Komunikimi përmes faqes së internetit dhe e-mail | | | MMPHI, MF, MBPZHR |

## KAPITULLI 6. KRAHASIMI I OPSIONEVE

### 6.1. Opsioni 1 - Asnjë ndryshim

Me zgjedhjen e Opsionit 1, korniza ligjore mbetet e pandryshuar.
Miratimi i Opsionit 1 do të rezultonte në mospërputhje me acquis të BE-së dhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Përveç kësaj, mospërputhjet me legjislacionin e miratuar rishtazi, mund të gjenerojnë kufizime në zbatim, për shkak të bashkëekzistencës së dispozitave të mundshme konfliktuale.

Duke pasur parasysh se parimet themelore të legjislacionit mjedisor janë të rregulluara në Ligj, mund të bëhen disa përmirësime përmes miratimit dhe ndryshimeve të legjislacionit sekondar përkatës.

### 6.2. Opsioni 2 - Opsioni për plotësim-ndryshim të ligjit ekzistues

Megjithatë, duke zgjedhur Opsionin 2, do të mbeten mangësitë në transpozimin e Direktivës për Përgjegjësinë Mjedisore, si dhe mospërputhjet ligjore dhe institucionale me kornizën ligjore të ndryshuar.

### 6.3. Opsioni 3 – Hartimi i Ligjit të ri

Opsioni i tretë është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative.

Për të ndryshuar Ligjin, nevojiten ndryshime të rëndësishme në kornizën aktuale ligjore. Ligji për mjedisin dhe legjislacioni tjetër përkatës primar dhe sekondar janë përfshirë.
Siç u përshkrua më lart, nevojiten disa ndryshime ligjore për të përmirësuar legjislacionin kombëtar me politikën ekzistuese mjedisore të BE-së dhe për të siguruar zbatimin e parimit `ndotësi paguan`.

Duke marrë parasysh ndryshimet e nevojshme, rekomandohet hartimi i Ligjit të ri për Mjedisin.
Nuk parashikohen ndryshime të rëndësishme institucionale; megjithatë, dispozitat e ligjit duhet të përafrohen me kornizën ekzistuese institucionale.

Zhvillimi i opsionit 3 mund të ketë një ndikim pozitiv në statusin e mjedisit dhe shëndetit dhe sigurimin e zbatimit të parimit `parandalimi` dhe `ndotësi paguan`.

Krahas vlerësimit të kryer Opsioni nr. 3 është Opsioni më i përshtatshëm për të përmirësuar legjislacionin ekzistues mjedisor në Kosovë dhe për t'u pajtuar me direktivat përkatëse të BE-së.
Opsioni 3 harmonizon legjislacionin ekzistues për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes industriale dhe siguron transpozimin e kornizes ligjore të BE-së në sistemin kombëtar.

*Tabela 16. Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i politikës** | Transpozimi i Direktivave të BE-së: Direktiva nr. 2004/35/CE “mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe korrigjimin e dëmit mjedisor” e ndryshuar | | | | | | | | Kostoja e pritshme |
| **Objektivi strategjik** | Për të harmonizuar kornizen ligjore mjedisore ekzistuese me politikën e fundit mjedisore të BE-së dhe ndryshimet ligjore kombëtare, për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e njeriut. | | | | | | | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizimi/departamenti përgjegjës | | | | | | | | |
| **Objektivi specifik 1**<br><br>**Hartimi i Ligjit dhe i akteve nënligjore përkatëse** | Produkti 1.1: Hartimi i Ligjit të ri | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni / Departamenti i përgjegjës | |
| | | Aktiviteti 1.1.1: Themelimi i Grupit Punues | X | | | | | MMPHI | |
| | | Aktiviteti 1.1.2: Hartimi i Ligjit | X | X | | | | MMPHI | |
| | | Aktiviteti 1.1.3: Miratimi | | X | | | | MMPHI | |
| **Objektivi specifik 2**<br><br>**Hartimi i akteve nënligjore** | Produkti 1.2.1. Krijimi i grupit të punës | Aktiviteti 1.2.1: Themelimi i Grupit Punues | | X | X | | | MMPHI | |
| | Produkti 1.2.2. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore | Aktiviteti 1.2.2: Hartimi dhe Miratimi i Projekt Akteve Nënligjore | | X | X | | | MMPHI | |
| **Objektivi specifik 3 Rritja e kapaciteteve të** | Produkti 3.1. Trajnimet e | Aktiviteti 3.1. Trajnimi i zyrtarëv | | X | X | X | X | MMPHI | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **institucioneve përgjegjëse** | mbajtura | e përkatës në fusha të ndryshme, që dalin nga Ligji i ri | | | | | | | |

### 6.5. Tabela krahasuese e tre opsioneve

*Tabela 17. Krahasimi i opsioneve - Përmbledhje e ndikimeve*

| Ndikimet / Opsioni | Opsioni 1 | Opsioni 2 | Opsioni 3 |
|---|---|---|---|
| **Ndikimet Ekonomike** | po | po | po |
| **Ndikimet sociale** | po | po | po |
| **Ndikimet Mjedisore** | po | po | po |
| **Të drejtat themelore gjinore** | po | po | po |
| **Përfitimet** | Miratimi i opsionit 1 nuk do të kërkojë ndryshime ligjore, duke shmangur çdo ndikim në ngarkesën e institucioneve kompetente.<br>Nuk ka detyrime dhe shpenzime shtesë për rishikimin e kornizes ligjore ekzistuese. | • Miratimi i legjislacionit sekondar që mungon do të përmirësojë zbatimin e ligjit.<br>• Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues, do të rrisë nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. | • Përmirësimi i harmonizimit ndërmjet legjislacionit dhe procedurave mjedisore.<br>• Niveli më i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit.<br>• Pajtueshmëria me MSA dhe me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes industriale.<br>• Sigurohet përafrimi me acquis të BE-së. |
| **Ndikimet negative** | Nuk ka përmirësim në nivelin e transpozimit të acquis të BE-së dhe | Nuk ka përmirësim në nivelin e transpozimit të acquis së BE-së dhe | Nevojiten ndryshime të rëndësishme në kornizen ligjore, kjo do të kërkojë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ruajtja e "Status quo-së" nuk do të ketë asnjë ndikim në procesin e përafrimit me acquis të BE-së. Zbatimi i parimit \`ndotësi paguan\` nuk do të përmirësohet. | me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. | përfshirjen e stafit teknik dhe ligjor me pasojë rritjen e ngarkesës. Operatorët do t'i nënshtrohen dispozitave të përgjegjësisë mjedisore, duhet të merren parasysh kostot shtesë për operatorët, veçanërisht për krijimin e mekanizmave financiarë |
| **Kostoja e ndikimeve** | --- | --- | -- |
| | | | |
| **Përmbledhje e konsultimit** | --- | --- | -- |

## KAPITULLI 7. KONKLUZIONET DHE HAPAT E ARDHSHËM

Qëllimi kryesor i këtij Koncept Dokumenti është të propozojë hartimin e një ligji të ri për mjedisin, për të përmirësuar legjislacionin ekzistues mjedisor në Kosovë, harmonizimi i legjislacionit ekzistues për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes industriale dhe transpozimin e kornizes ligjore të BE-së në sistemin kombëtar si dhe zbatimin e parimit `ndotësi paguan.

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti nga ana e Qeverisë, MMPHI do të themelojë grup punues për Hartimin e projektligjit të ri dhe akteve nënligjore që burojnë nga i njëjti.

### 7.1. Dispozita për monitorim dhe vlerësim

Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin e saj nr. 07/145 dt. 07.06.2023, ka miratuar Udhërrëfyesin për vlerësimin ex-post të legjislacionit në Republikën e Kosovës, i cili shërben për të vendosur hapat që kërkohen të ndërmerren për të bërë vlerësimin ex-post.

Rrjedhimisht, monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i zbatimit të këtij i rekomanduara me këtë koncept dokument do të udhëhiqet nga MMPHI dhe do të bëhet sipas metodologjisë së vlerësimit ex-post të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## SHTOJCA 1: FORMULARI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT EKONOMIK

| **Kategoria e ndikimeve ekonomike** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritur ose ndikimi në kosto** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë / i ulët** | **I lartë / i ulët** | |
| **Vendet e punës**[27] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | x | | | | |
| | A do të reduktohet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A do të ndikojë në nivelin e pagesës? | | x | | | |
| | A do të ndikojë në lehtësinë e gjetjes së një pune? | | x | | | |
| **Të bërit biznes** | A do të ndikojë në aksesin në financat e biznesit? | | x | | | |
| | A do të tërhiqen disa produkte nga tregu? | | x | | | |
| | A do të lejohen produkte të caktuara në treg? | x | | | | |
| | A do të detyrohen të mbyllen bizneset? | | x | | | |
| | A do të krijohen biznese të reja? | | x | | | |
| **Barra administrative** | A do të detyrohen bizneset të përmbushin detyrimet e dhënies së informacionit të ri? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informacionit për bizneset? | x | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ligji i ri per mjedis do te trajtojë edhe uljen e barres administrative per palet (bizneset/qytetaret) | x | | | | |
| **Tregtia** | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importeve? | | x | | | |
| | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksporteve? | | x | | | |
| **Transporti** | A do të ketë efekt në mënyrën se si transportohen pasagjerët dhe/ose mallrat? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra? | | x | | | |
| **Investimet** | A pritet që kompanitë të investojnë në aktivitete të reja? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A pritet që kompanitë të anulojnë apo shtyjnë investimet? | | x | | | |
| | A do të rriten investimet nga diaspora? | x | | | | |
| | A do të ulen investimet nga diaspora? | | x | | | |
| | A do të rriten investimet e huaja direkte? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të ulen investimet e huaja direkte? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| **Konkurrues h-mëria** | A do të rritet çmimi i produkteve të biznesit, si energjia elektrike? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të ulet çmimi i inputeve të biznesit, si energjia elektrike? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A ka gjasa të promovohen inovacioni dhe kërkimi? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A ka gjasa të pengohen inovacioni dhe kërkimi? | | x | | | |
| **Ndikimi në NVM-të** | A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM? | x | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Çmimi dhe konkurrenca** | A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion të biznesit apo konsumatorëve? | x | | | | |
| | A do të ulet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion të biznesit apo konsumatorëve? | | x | | | |
| | A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| | A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| **Ndikimet ekonomike rajonale** | A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? | x | | | | |
| | A është ky sektor i përqendruar në një rajon të caktuar? | | x | | | |
| **Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik** | A do të ndikohet rritja ekonomike në të ardhmen? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit? | | x | | | |

## SHTOJCA 2: FORMULARI I VLERËSIMIT PËR NDIKIMET SOCIALE

| Kategoria e ndikimeve sociale | Ndikimi kryesor | A pritet të ndodhë ky ndikim? | | Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur | Përfitimi i pritur ose ndikimi në kosto | Niveli i preferuar i analizës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë / i ulët** | **I lartë / i ulët** | |
| **Vendet e punës**[28] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A do të reduktohet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A preken vendet e punës në një sektor të caktuar biznesi? | x | | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në lehtësinë e gjetjes së një pune? | x | | | | |
| **Ndikimet sociale rajonale** | A janë të përqendruara ndikimet shoqërore në një rajon apo qytet të caktuar? | | x | | | |
| **Kushtet e punës** | A preken të drejtat e punëtorëve? | | x | | | |
| | A parashikohen apo hiqen standardet për të punuar në kushte të rrezikshme? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ndikojë në mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve? | | x | | | |
| **Përfshirja sociale** | A do të ketë ndikim në varfëri? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A ndikohet aksesi në skemat e mbrojtjes sociale? | x | | | | |
| | A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve bazë? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale? | | x | | | |
| **Edukimi** | A do të ketë ndikim në arsimin fillor? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm? | x | | | | |
| | A do të ndikojë në arsimin e lartë? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në formimin profesional? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në edukimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor? | x | | | | |
| | A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen? | x | | | | |
| **Kultura** | A ndikon Opsioni në diversitetin kulturor? | x | | | | |
| | A ndikon Opsioni në financimin e organizatave kulturore? | | x | | | |
| | A ndikon Opsioni në mundësitë që njerëzit të përfitojnë ose të marrin pjesë në aktivitete kulturore? | x | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon Opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore? | x | | i ulët | i lartë | i ulët |
| **Qeverisja** | A ndikon Opsioni në aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin demokratik? | x | | i lartë | i ulët | i ulët |
| | A trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë? | x | | | | i ulët |
| | A do të informohet më mirë publiku për disa çështje? | x | | i lartë | i ulët | i ulët |
| | A ndikon Opsioni në mënyrën e funksionimit të partive politike? | | x | | | i ulët |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civ | x | | | | i ulët |
| **Shëndeti dhe siguria publike** [29] | A do të ketë ndonjë efekt në jetën e njerëzve, si jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndikojë në cilësinë e ushqimit? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të rritet apo ulet rreziku për shëndetin për shkak të substancave të dëmshme? | | x | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës ose cilësisë së ajrit, ujit dhe/ose tokës? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në depozitimin e mbeturinave? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ketë ndikim në stilin e jetës së njerëzve, si nivelet e interesit për sportin, ndryshimet në të ushqyerit, apo ndryshimet në përdorimin e duhanit apo alkoolit? | | x | | | |
| | A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerët (të përcaktuara nga faktorë të tillë si mosha, gjinia, paaftësia, grupi social ose rajoni)? | | x | | | |
| **Krimi dhe siguria** | A ndikon në gjasat që kriminelët të kapen? | | x | | | |
| | A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi? | | x | | | |
| | A ndikon në nivelin e korrupsionit? | | x | | | |
| | A preket kapaciteti i zbatimit të ligjit? | | x | i lartë | i lartë | i lartë |

## SHTOJCA 3: FORMULARI I VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN NË MJEDIS

| **Kategoria e ndikimit mjedisor** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritur ose ndikimi në kosto** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë / i ulët** | **I lartë / i ulët** | |
| **Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm** | A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serrë (dioksid karboni, metan, etj.)? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndikohet konsumi i karburantit? | x | | i ulët | i lartë | i ulët |
| | A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve të përdorura për të prodhuar energji? | x | | | i lartë | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim çmimi për produktet miqësore me mjedisin? | | x | | | |
| | A do të bëhen disa aktivitete më pak ndotëse? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| **Cilësia e ajrit** | A do të ndikojë në emetimin e ndotësve të ajrit? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| **Cilësia e ujit** | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| **Cilësia dhe përdorimi i tokës** | A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, | x | | i lartë | i lartë | i ulët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | përdorimin e pesticideve apo herbicideve)? | | | | | |
| | A do të ndikojë në erozionin e tokës? | | x | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të humbet toka (përmes ndërtimit, etj.)? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të merret toka (përmes dekontaminimit, etj.)? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në përdorimin e tokës (p.sh. nga përdorimi i pyjeve në përdorim bujqësor ose urban)? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| **Mbeturinat dhe riciklimi** | A do të ndryshojë sasia e mbetjeve të gjeneruara? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbetjeve? | x | | i lartë | i ulët | i ulët |
| **Përdorimi i burimeve** | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të rinovueshme (stoqet e peshkut, hidrocentralet, energjia diellore, etj.)? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve jo të rinovueshme (ujëra nëntokësore, minerale, qymyr, etj.)? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e rrezikshmërisë mjedisore** | A do të ketë ndonjë efekt mbi rreziqet e mundshme, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore? | | x | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| **Biodiversiteti, flora dhe fauna** | A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo zonat ku ato jetojnë? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndikohet madhësia ose lidhjet midis zonave të natyrës? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| **Mirëqenia e kafshëve** | A do të ndikohet trajtimi i kafshëve? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndikohet shëndeti i kafshëve? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| | A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |

## SHTOJCA 4: FORMULARI I VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN E TË DREJTAVE THEMELORE

| **Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritur ose ndikimi në kosto** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë / i ulët** | **I lartë / i ulët** | |
| **Dinjiteti** | A ndikon Opsioni në dinjitetin e njerëzve, të drejtën e tyre për jetë apo integritetin e një personi? | x | | i lartë | i lartë | i ulët |
| **Liria** | A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? | x | | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? | x | | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo për të krijuar familje? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike apo sociale të individëve apo familjeve? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjës apo fesë? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në lirinë e tubimit apo organizimit? | | x | | | |
| **Të dhënat personale** | A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A janë të garantuara të drejtat individuale të aksesit (qasjes), korrigjimit dhe kundërshtimit? | x | | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra se si përpunohen të dhënat personale? | | x | | | |
| **Azili** | A ndikon ky opsioni në të drejtën e azilit? | | x | | | |
| **Të drejtat pronësore** | A do të preken të drejtat pronësore? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes? | | x | | | |
| **Trajtimi i barabartë** [30] | A e mbron ky opsion parimin eFsë përballë ligjit? | x | | | | |
| | A ka gjasa që grupe të caktuara të dëmtohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim i bazuar në gjini, racë, ngjyrë, përkatësi etnike, opinion | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | politik ose tjetër, moshë ose orientim seksual)? | | | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? | | x | | | |
| **Të drejtat e fëmijëve** | A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| **Administrimi i mirë** | A do të ndërlikohen procedurat administrative? | | x | i ulët | i ulët | i ulët |
| | A ndikohet mënyra e marrjes së Vendimit nga administrata (transparenca, afati procedural, e drejta e aksesit në dosje, etj.)? | | x | i ulët | i lartë | i ulët |
| | Në të drejtën penale dhe dënimet e parapara: a preken të drejtat e të pandehurit? | | x | | | i ulët |
| | A ndikohet qasja në drejtësi? | | X | i lartë | i lartë | i ulët |